



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 34 regjistër (JR)
Datë 21.06.2021

Nr. 26 i vendimit
Datë 29.05.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 29.05.2024, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare Marie Tuma, me sekretare gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 34/2021 (JR), datë 21.06.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Bari Shyti, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 361, datë 25.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Kodi i Procedurave Administrative; nenet 63 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 361, datë 25.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Bari Shyti (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse, prej të cilave rezultoi si më poshtë.
 - 2.1. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - i. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - ii. *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - iii. *Ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - iv. *Ka kryer deklarim të rremë dhe ka falsifikim dokumentacioni;*
 - v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
 - 2.2. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë raportin e Grupit të Punës, duke konstatuar se:
 - i. *Subjekti i rivlerësimit, z. Bari Shyti, ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si të deklaruara apo të paraqitura në deklaratën për kontrollin e figurës;*

- ii. *Nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Bari D. Shyti.

2.3. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 361, datë 25.03.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 361, datë 25.03.2021, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

4.1. *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:* subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet pikës 5, të nenit 33 të këtij ligji, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

4.2. *Për kriterin e kontrollit të figurës:* subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:* subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 31.05.2021, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 361, datë 25.03.2021, të Komisionit, duke kërkuar që Kolegji i Posaçëm i Apëlimit (në vijim “Kolegji”) të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
- *Prishjen e vendimit nr. 361, datë 25.03.2021, të Komisionit.*
 - *Konstatimin e pavlefshmërisë së procedurës së hetimit administrativ, seancës dëgjimore, vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare të trupit gjyqësor.*

- *Korrigjimin e gabimeve procedurale të vendimit, duke e gjykuar çështjen në seancë gjyqësore publike.*

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Bari Shyti, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.*

6. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat në tërësinë e tyre kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësimin siç duhet të provave të administruara nga Komisioni.

6.1. Shkaqet e ankimit, që i përkasin natyrës procedurale dhe parimeve të cenuara të procesit të rregullt ligjor, janë si vijojnë.

6.1.1 *Procesin e rivlerësimit në Komision në fazën përfundimtare të tij e kanë ndikuar faktorë të jashtëm, ndaj edhe vendimi përfundimtar ka mjaft paqartësi dhe konkluzione konfuze dhe kontradiktore.*

6.1.2 *Pas datës së zhvillimit të seancës dëgjimore, Komisioni vendosi t'i japë vetes vetëm dy ditë kohë për të analizuar gjithë provat, prapësimet dhe analizat financiare të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit deri në datën 19.03.2021 dhe në seancë dëgjimore, si dhe gjithë problematikën komplekse të çështjes.*

6.2. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

6.2.1 *Në një analizë të thjeshtë e pa kalkulime të sofistikuar financiare, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklarimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme parashikuar nga neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë nuk gjendet në kushtet e papajtueshmërisë për të vijuar detyrën.*

6.2.2 *Komisioni, duke vlerësuar në mënyrë të kundërligjshme kriterin e pasurisë si “deklarim të pamjaftueshëm”, në kuadër të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk duhet të arrinte në përfundimin për shkarkimin nga detyra të subjektit, pasi nuk rezulton kushti i dytë kumulativ që kjo dispozitë kërkon, vlerësimi i papërshtatshëm për kriterin e figurës.*

6.2.3 *Për pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 57.64 m², në Durrës”:*
Konkluzioni i Komisionit se pagesa për blerjen e pasurisë “apartament banimi në Durrës” në shumën 1.440.000 lekë është kryer në vitin 2005 është i padrejtë, pasi Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ, duke sjellë kjo një balancë të konsiderueshme negative, në analizën financiare për këtë pasuri.

6.2.4 *Për pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 107 m², në Tiranë:*

a) *Në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, shuma 21.000 USD e siguruar nga puna e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortes së tij në grumbullimin e mineralit të kromit, është e ardhur e ligjshme dhe, për rrjedhojë, edhe pasuria “apartament banimi”, në Tiranë, e krijuar me këtë të ardhur, është pasuri e ligjshme.*

b) Në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, shuma 18.500 euro është e ardhur nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për të cilat janë dhënë deklarime bindëse dhe të mjaftueshme dhe, për rrjedhojë, edhe pasuria apartament banimi në Tiranë, e krijuar me këtë të ardhur, është pasuri e ligjshme, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

c) Konkluzionet e Komisionit lidhur me tërheqjen prej subjektit të rivlerësimit të depozitës në Tirana Bank, që ka shërbyer si burim për pagesën e këstit të dytë për pasurisë apartament banimi, në Tiranë, si dhe konkluzioni se nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për pagimin e shumës 400.000 lekë në favor të z. H. Sh., në vitin 2010, janë të pabazuara.

d) Në të kundërt të sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka provuar bindshëm se shuma 9.000 USD është një e ardhur e ligjshme, jo vetëm se rrjedh nga një marrëdhënie korrekte huadhënie, por edhe se huadhënësi ka pasur burime financiare të mjaftueshme dhe të ligjshme për huazimin e kësaj shume.

Konstatimi i Komisionit lidhur me konfliktin në dukje të interesit gjatë gjykimit të tri çështjeve civile, në të cilat palë ndërgjyqëse ka qenë shoqëria “{***}” ShPK, është krejtësisht i gabuar.

6.2.5 Për analizën financiare 2003-2016:

a) Nga ana e Komisionit, pa ndonjë argument bindës, për periudhën 2000-2012, nuk është marrë në konsideratë fakti që një pjesë të produkteve ushqimore ai i ka siguruar nga toka bujqësore me sip. 5,7 dynym në pronësi të tij.

b) Komisioni nuk i ka llogaritur drejt shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, pasi i ka korrigjuar pjesërisht dhe, në vendimin përfundimtar, jo vetëm nuk ka njohur disa udhëtime me kosto qëndrimi të mbuluar nga të tretët, por edhe në ato dy raste që ka pranuar se kostoja e qëndrimit është mbuluar nga të tretët, nuk është i qartë në atë se çfarë ka njohur si kosto ditore.

c) Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare për të shlyer shumën prej 4.000 USD, në vitin 2011, ka ardhur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të deklaratës periodike të interesave të vitit 2011, duke shfrytëzuar edhe ndonjë gabim në mënyrën e deklaratimit apo hapësirën e deklaratës ku janë pasqyruar kursimet.

6.2.6 Deklarimi i pasaktë i shtëpisë në Bulqizë qëndron vetëm në faktin se prej subjektit të rivlerësimit nuk është deklaruar investimi prej 200.000-250.000 lekësh i kryer gjatë vitit 2004, për pasojë qëndrimi i Komisionit nuk është i drejtë.

7. Subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit, që bazuar në parashikimet e neneve 45, 49, 52 dhe 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të merren në shqyrtim e të vlerësohen aktet e paraqitura prej tij bashkëlidhur ankimit, si më poshtë.

7.1. Kallëzim penal, datë 08.04.2021, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kallëzues Bari Shyti dhe të kallëzuar Mediat “{***}” dhe “{***}”, si dhe një person i paidentifikuar, për veprat penale të “Fyerjes”, parashikuar nga neni 119/2 i Kodit Penal, “Zbulimit të akteve ose të dhënave sekrete”, parashikuar nga neni 259/a, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal dhe “Shfrytëzimit të paligjshëm të të dhënave tregtare”, parashikuar nga neni 259/b i Kodit Penal.

7.2. Shkresë nr. {***} prot., datë 07.04.2021, e Gardës së Republikës, drejtuar z. Bari Shyti.

7.3. Shkresë nr. {***} prot., datë 27.05.2021, e Gardës së Republikës, drejtuar z. Bari Shyti.

- 7.4. Kallëzim penal, datë 25.03.2021, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kallëzues Bari Shyti dhe të kallëzuar një grup qytetarësh të paidentifikuar, për veprat penale të “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, “Mosmarrje e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme” dhe “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, të parashikuara nga nenet 245/1, 251 dhe 262 të Kodit Penal.
- 7.5. Shkresë nr. {***} prot., datë 09.04.2021, e Autoritetit të Mediave Audiovizive, drejtuar z. Bari Shyti.
- 7.6. Memo, drejtuar drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga z. Bari Shyti.
8. Subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Kolegj një material të titulluar “Plotësim ankimi kundër vendimit nr. 361, datë 25.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 13.05.2024 dhe bashkëlidhur tij ka dorëzuar edhe disa akte shkresore¹.

¹ Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet:

Deklaratë noteriale nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 16.11.2023, e deklaruesit I. Sh.;

Deklaratë noteriale nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 29.12.2023, e deklarueses N. H.;

Kontratë sipërmarrje (premtim shitje) nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 02.02.2015, me palë sipërmarrëse shoqërinë “{***}” ShPK dhe palë porositëse z. I. Sh.;

Kallëzim penal, datë 25.03.2021, me kallëzues: Bari Shyti, të kallëzuar: një grup qytetarësh të paidentifikuar; me objekt: “Kallëzim për veprat penale “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, “Mosmarrje e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme” dhe “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, të parashikuara nga nenet 245/1, 251 dhe 262 të Kodit Penal”, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me nr. {***} prot., datë 25.03.2021;

Printim nga faqja e rrjetit social “Instagram” të RTV “{***}”, të një fotoje, me postimin e mesazhit “Gjyqtari Bari Shyti është gjendur në vështirësi kur një tek dera e godinës së KPK-së pa një grup qytetarësh [...]”;

Vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 19.06.2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;

Kërkesë Ankimore, datë 05.11.2021, me ankues Bari Shyti dhe objekt: Kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 19.06.2021, “Për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e regjistruar me nr. {***}, viti 2021”, depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {***} Regj. Them., datë 23.12.2021, me ankues Bari Shyti, kundër: Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: Kundërshtimi i vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 19.06.2021, “Për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e regjistruar me nr. {***}, viti 2021”;

Ankim, datë 09.01.2022, me ankues Bari Shyti dhe objekt: “Kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {***} Regj. Them., datë 23.12.2021”, depozituar më datë 20.01.2022;

Shkresë nr. {***} prot., datë 07.04.2021, e Komandantit të Gardës së Republikës, me lëndë: “Kthim përgjigje”, drejtuar z. Bari Shyti;

Shkresë nr. {***} prot., datë 27.05.2021, e Komandantit të Gardës së Republikës, me lëndë: “Kthim përgjigje”, drejtuar z. Bari Shyti;

Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {***}, datë 24.03.2023, me viktimë akuzuese: z. Bari Shyti; I akuzuar: Shoqëria “{***}” ShPK, me akuzë: “Për kryerjen e veprës penale të “Fyerjes” dhe “Shpifjes”, të parashikuara nga nenet 119/2 dhe 120/2 të Kodit Penal”;

Ankim, datë 17.05.2023, me ankues: Bari Shyti dhe objekt: “Kundërshtimin e vendimit nr. {***}, datë 24.03.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,” depozituar më datë 17.05.2023;

Kallëzim penal, datë 08.04.2021, me kallëzues: Bari Shyti, të kallëzuar: mediat audiovizive dhe elektronike “{***}”, “{***}” dhe një person i paidentifikuar, me objekt: “Kallëzim për ndjekje penale për kryerjen e veprës penale të “Fyerjes” parashikuar nga neni 119/2 i Kodit Penal, për kryerjen e veprës penale të “Zbulimit të akteve ose të dhënave sekrete”, parashikuar nga neni 295/a, paragrafi 1, 2 i Kodit Penal, si dhe për kryerjen e veprës penale të “Shfrytëzimit të paligjshëm të të dhënave tregtare”, parashikuar nga neni 295/b i Kodit Penal”, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me nr. {***} prot., datë 09.04.2021;

Vendim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë “Për mosfillimin e procedimit”, datë 02.05.2021.

Në datën 15.05.2024, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Kolegj materialin shkresor “Plotësim ankimi kundër vendimit nr. 361, datë 25.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”², i cili ishte i njëjtë me materialin shkresor të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 13.05.2024, përveç korrigjimit të disa gabimeve në shifra, si dhe sqarimit të provave.

Në datën 27.05.2024, subjekti i rivlerësimit dërgoi në Kolegj, nëpërmjet postës elektronike, materialin shkresor “Në vijim të parashtrimeve shtesë lidhur me ankimin kundër vendimit nr. 361, datë 25.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bari Shyti, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 361, datë

Shkresë nr. {***} prot., datë 10.04.2021, e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me lëndë: “Mbi kërkesën tuaj për informacion lidhur me portalin “Pamfleti”, drejtuar z. Bari Shyti;

Shkresë nr. {***} prot., datë 09.04.2021, e Autoritetit të Mediave Audiovizive, me lëndë: “Dërgohet përgjigjja e Këshillit të Ankesave pranë AMA-s, në lidhje me ankesën tuaj”, drejtuar z. Bari Shyti;

Shkresë nr. {***} prot., datë 23.06.2021, e Autoritetit të Mediave Audiovizive, me lëndë: “Dërgohen konkluzionet e Këshillit të Ankesave pas shqyrtimit të ankesës suaj”, drejtuar z. Bari Shyti;

Memo, datë 10.05.2021, e z. Bari Shyti, drejtuar: Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Rikujtesë, datë 20.09.2021, e z. Bari Shyti, drejtuar: z. K. B., prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë dhe për dijeni: Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

² Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 15.05.2024.

25.03.2021, të Komisionit, për shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit Bari Shyti, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.

12. Trupi gjykues, fillimisht, mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale të Komisionit, që do të cenonte procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), si vijon.

13. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *nuk mund të fshehë dyshimin se faktorë të jashtëm kanë ndikuar procesin e rivlerësimit në Komision në fazën përfundimtare të tij, ndaj edhe vendimi përfundimtar ka mjaft paqartësi dhe konkluzione konfuze dhe kontradiktore.*

Në mbështetje të këtij shkak, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se seanca dëgjimore e datës 23.03.2021 është zhvilluar në kushte të pazakonta, pasi është sulmuar me fyerje e shpifje, nga një grup protestuesish të paidentifikuar, të cilët kishin zënë vend para godinës ku do të zhvillohej seanca dëgjimore dhe mbanin në duar pankarta me mbishkrime fyese dhe kërcënuese në adresë të tij dhe të Komisionit. Për pasojë, seanca dëgjimore është zhvilluar në kushte tërësisht të parregullta për t’u konsideruar një gjykim sipas standardeve të KEDNj-së, në kuptim të aksesit para një autoriteti gjyqësor të paanshëm që garanton të drejtën për t’u gjykuar, pasi përqendrimi i subjektit ishte cenuar rëndë. Sipas subjektit të rivlerësimit, heshtja e Komisionit ndaj këtyre akuzave publike, në vend që t’i verifikonte ato, përbën fakt të mjaftueshëm që të krijoj bindjen se Komisioni është ndikuar nga këto veprime të paligjshme.

13.1. Në kuadër të analizës së këtij pretendimi, nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 23.03.2021, trupi gjykues vëren se këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit nuk e ka ngritur në asnjë moment gjatë zhvillimit të kësaj seance në Komision. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shprehur asnjë pretendim lidhur me shkaqe që e pengonin për t’u përqendruar në zhvillimin e seancës dëgjimore dhe nuk ka parashtruar asnjë kërkesë për shtyrje të zhvillimit të saj. Në të kundërt ai ka marrë pjesë aktive në seancë, duke shprehur qëndrimin e tij ndaj gjetjeve të Komisionit, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues të Komisionit.

13.2. Në çështjen *Craxi kundër Italisë*, 2003, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur: “Në një kuptim të përgjithshëm, gjyqtarët nuk mund të funksionojnë në një vakum: megjithëse ata kanë në kompetencë të vendosin mbi fajësinë ose pafajësinë e një të akuzuari, nuk rrjedh nga kjo që, çështjet për të cilat ata janë vënë në dijeni, nuk mund të diskutohen, qoftë në revista të specializuara, në shtypin kryesor ose në publik. [...] Kjo është edhe më e vërtetë kur procesi, siç është rasti në fjalë, është për një person të njohur, një ish-kryeministër. Këta njerëz, në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije, ekspozohen ndaj një kontrolli të vëmendshëm, si nga gazetarët, ashtu edhe nga masa e qytetarëve”. Nën dritën e kësaj jurisprudence, trupi gjykues vlerësoi se, bazuar në nenin 179/b, pika 6 e Kushtetutës dhe në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ushtron funksionet si institucion i pavarur dhe i paanshëm, mbi bazën e parimeve të

barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Komisioni vendos bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme. Interesi i qytetarëve për procesin e rivlerësimit ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, nën dritën e qëllimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, është më se i kuptueshëm. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk i verifikoi shpifjet e protestuesve ndaj figurës së tij, vërehet se ligji nr. 84/2016, në nenin 53 të tij, ka përcaktuar qartësisht mekanizmat e pjesëmarrjes së publikut në procesin e rivlerësimit, nëpërmjet informimit drejtpërdrejt të institucioneve të rivlerësimit, lidhur me fakte ose rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit. Në këtë kuadër, ngjarja e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, del jashtë përgjegjësisë së verifikimit nga Komisioni, pasi nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë denoncim për subjektin e rivlerësimit, në datën e zhvillimit të seancës dëgjimore publike. Protesta e pretenduar se është zhvilluar përpara godinës së Komisionit dhe mesazhet që janë përcjellë në të janë çështje që dalin jashtë kontrollit të Komisionit mbi procesin e rivlerësimit, për pasojë nuk mund të ishin objekt shqyrtimi në çështjen e subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, nuk janë konsideruar prej Komisionit.

13.3. Subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar e nuk ka paraqitur asnjë provë që, nëpërmjet shkakut të ankimit, në mënyrë objektive, të vërtetojë ndikimin që kjo protestë ka pasur në vlerësimin e tij nga Komisioni.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

14. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *pas datës së zhvillimit të seancës dëgjimore, Komisioni vendosi t'i japë vetes vetëm dy ditë kohë për të analizuar gjithë provat, prapësimet dhe analizat financiare të paraqitura nga subjekti deri në datën 19.03.2021 dhe në seancë dëgjimore, si dhe gjithë problematikën komplekse të çështjes.*

14.1. Në analizë të këtij shkakut ankimi, nga tërësia e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vëren se me vendimin nr. 1, datë 21.11.2018, anëtarët e trupit gjykues të Komisionit kanë deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit dhe Komisioni ka vendosur fillimin e hetimit administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016. Gjatë zhvillimit të procesit të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit paraqitjen e shpjegimeve dhe provave, nëpërmjet dërgimit të pyetësorëve, në funksion të rrethanave dhe nevojave të këtij hetimi. Me vendimin nr. 2, datë 08.09.2020, Komisioni ka vendosur përfundimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Me vendimin nr. 3, datë 19.10.2020, pas analizimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit³, Komisioni ka vendosur riçeljen e hetimit

³ Siç është cituar në paragrafin 18 të vendimit të Komisionit. Në preambulën e vendimit nr. 3, datë 19.10.2020, Komisioni ka cituar: "Pasi dëgjoji relatimin e bërë nga relatori i çështjes dhe studio materialin e përgatitur për këtë qëllim (rezultatet e hetimit shtesë), trupi gjykues vendosi: [...]".

administrativ, me qëllim kryerjen e disa hetimeve shtesë për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe përfshirjen e kriterit të kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale në procesin e rivlerësimit të subjektit. Me vendimin nr. 4, datë 04.03.2021, Komisioni vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ shtesë për subjektin e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit; si dhe (iii) të informojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara, të drejtat për të kërkuar marrjen e provave të reja etj., si dhe dorëzimin e prapësimeve deri më datë 16.03.2021.

Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni për çdo rezultat është shprehur qartë se në cilat prova është bazuar, duke i cituar ato, përfshirë edhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit deri në këtë fazë të hetimit. Për çdo gjetje, rezultatet e hetimit përmbajnë analizën e provave dhe analizën financiare, kur është rasti. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me dosjen dhe ka marrë kopje të saj⁴, ka paraqitur shpjegimet dhe parashtrimet e tij në Komision në datat 16.03.2021 dhe 17.03.2021, të cilat i ka ridërguar edhe më datë 19.03.2021.

Pas shqyrtimit të parashtrimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit⁵, me vendimin nr. 5, datë 19.03.2021, Komisioni vendosi kalimin në seancë dëgjimore, duke e njoftuar subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 23.03.2021. Në datën 23.03.2021 u zhvillua seanca dëgjimore publike, në të cilën relatorja e çështjes ka parashtruar gjetjet e rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me to, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij dhe u është përgjigjur pyetjeve të bëra nga Komisioni dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar. Subjekti i rivlerësimit, në këtë seancë, ka paraqitur akte të cilat janë administruar nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë të gjitha dokumentet, pjesë përbërëse e dosjes së rivlerësimit dhe nuk ka kundërshtuar elemente procedurale të procedurës së hetimit të zhvilluar ndaj tij apo elemente procedurale të lidhura me zhvillimin e seancës dëgjimore.

Trupi gjykues vëren se periudha kohore që Komisioni kishte në dispozicion për të shqyrtuar parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e paraqitura prej tij në funksion të barrës së provës, ka qenë gjashtë ditë nga data 17.03.2021 [kur u dorëzuan plotësisht këto akte] deri më datë 23.03.2021 [data e zhvillimit të seancës së parë dëgjimore]. Në këto kushte, trupi gjykues konstatoi se Komisioni kishte kohën e mjaftueshme për të shqyrtuar parashtrimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe për të vlerësuar kalimin në seancë dëgjimore publike.

Në seancën dëgjimore të datës 23.03.2021, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës së re aktet: (i) fotokopje pasaportë/kartë identiteti për 3 shtetas; (ii) fotokopje të disa fletëve të pasaportës së tij; (iii) fotografi të familjes së tij; (iv) shkresën nr. {***} prot., datë 17.02.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, lidhur me çështjet e shqyrtuara prej subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit në këtë gjykatë; si dhe (v) fotokopje të një dokumenti në gjuhën gjermane, lëshuar për z. I. Sh.. Nisur nga përmbajtja e akteve të sipërcituara, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se periudha dyditore e shqyrtimit të tyre, nga data e

⁴ Deklaratë datë 02.10.2020 dhe deklaratë datë 10.03.2021, të nënshkruara nga subjekti, në të cilat deklarohen njohjen me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike të dosjeve të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, si marrjen e dokumentacionit në CD dhe/apo në formë shkresore.

⁵ Siç është cituar në paragrafin 21 të vendimit të Komisionit.

zhvillimit të seancës dëgjimore e deri në momentin e shpalljes së vendimit, në datën 25.03.2021, nuk mund të konsiderohet si kohë e pamjaftueshme për shqyrtimin e tyre prej Komisionit.

14.2. Referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se në tërësinë e tij, ky vendim përmban analizën e akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit përgjatë hetimit administrativ. Kjo e dhënë dëshmon se Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimit të tij provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit. Fakti se këto prova, Komisioni nuk i ka vlerësuar në mënyrën e dëshiruar prej subjektit të rivlerësimit nuk do të thotë se ka munguar vlerësimi lidhur me to, në kuptim të garantimit të elementeve të procesit të rregullt ligjor.

15. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për shkelje të rënda procedurale dhe për shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, u gjetën të pabazuara në fakte e në ligj. Për rrjedhojë, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve.
16. Kërkesa e subjektit për marrjen në cilësinë e provës së akteve të paraqitura bashkëlidhur ankimit, u analizua nga trupi gjykues, në këndvështrimin e dispozitës ligjore që përligj pranimin e provave të reja në gjykimin administrativ të apelit, konkretisht nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Nga analizimi i këtyre akteve shpresore, trupi gjykues vëren se ato janë akte që provojnë veprime të kryera pas dhënies nga Komisioni të vendimit nr. 361, datë 25.03.2021 dhe lidhen me shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 13 më sipër, në këtë vendim. Në kushtet kur shkakun e ankimit se faktorë të jashtëm kanë ndikuar procesin e rivlerësimit të subjektit në Komision, në fazën përfundimtare të tij, u gjet i pabazuar, trupi gjykues vlerësoi se marrja e akteve të sipërcituara në cilësinë e provës është e panevojshme dhe e parëndësishme për vendimmarrjen e Kolegjit, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
Sa i përket akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet e paraqitura pesë ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas së cilave deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe, për këto arsye, i përjashtoi nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes.
17. Në përfundim edhe të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë të akteve, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

18. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *në një analizë të thjeshtë e pa kalkulime të sofistikuara financiare, ai nuk gjendet në kushtet e deklaramit të dyfishit të pasurisë së ligjshme parashikuar nga neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë nuk gjendet në kushtet e papajtueshmërisë për të vijuar detyrën.*

18.1. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se e gjithë pasuria e tij e luajtshme dhe e paluajtshme, për të cilën janë kryer hetime nga Komisioni, është në vlerën totale prej afro 14.500.000 lekësh, ndërkohë të ardhurat e ligjshme deri në fund të vitit 2016 janë në vlerën totale prej 28.250.000 lekësh. Për pasojë, pasuria e krijuar ndër vite, zë afërsisht ½ e vlerës së të ardhurave. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk gjendet në kushtet e mosjustifikimit deri në dyfishin e pasurisë së deklaruar, kushte për të cilat parashikimet kushtetuese e konsiderojnë atë fajtor/të papërshtatshëm dhe vetëm në këto rrethana mund t'i kalonte barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të hetimit administrativ.

18.2. Trupi gjykues, në përputhje dhe me jurisprudencën e Kolegjit, lidhur me kërkesa të ngjashme në çështje të mëparshme, çmoi se konstatimi i dyfishit të pasurisë së ligjshme është vetëm një ndër gjashtë rrethanat ligjore të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, vërtetimi i të cilave passjell shkarkimin nga detyra të subjekteve të rivlerësimit dhe secila prej situatave ligjore mund të zbatohet edhe veçmas. Masa disiplinore për subjektin e rivlerësimit Bari Shyti është marrë për deklaramit të pasaktë e të pamjaftueshëm, parashikuar nga pika 3 e së njëjtës dispozitë, për pasojë trupi gjykues arriti në konkluzionin se shkakut i ankimit është i pabazuar në ligj.

19. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni duke vlerësuar në mënyrë të kundërligjshme kriterin e pasurisë si “deklaramit të pamjaftueshëm”, në kuadër të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk duhet të arrinte në përfundimin për shkarkimin nga detyra të subjektit, pasi nuk rezulton kushti i dytë kumulativ që kjo dispozitë kërkon, vlerësimi i papërshtatshëm për kriterin e figurës.* Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se, edhe nëse kushtet e përcaktuara në nenin 61, pika 3 do të ishin të ndara, termi “deklaramit i pamjaftueshëm” nënkupton që kjo përbën sjelljen më të rëndë të subjektit në lidhje me kriterin e pasurisë, e cila duhet të ketë të njëjtin nivel kundërligjshmërie sikurse shkeljet e renditura në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të të njëjtit nen.

19.1. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues u mbështet në qëndrimin e konsoliduar në jurisprudencën⁶ e Kolegjit, sipas së cilës në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i kriterit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, respektivisht, mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga kjo dispozitë, nëse deklaramiti i subjektit për kriterin objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Parashikimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si situata të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport apo të ndërlidhura me njëra-tjetrën, por shihen si situata të pavarura, në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr.

⁶ Vendimi nr. 33, datë 29.07.2022, i Kolegjit, paragrafi 19 etj.

84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në drejtim të sa më sipër, gjenden të pabazuara.

20. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit, duke u fokusuar në disa shkaqe ankimi ose çështje, siç i ka quajtur ai në ankim, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nëse zgjidhen këto çështje, pasuritë e deklaruara prej tij janë rrjedhojë e burimeve të ligjshme të të ardhurave dhe balancat e analizës financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit rezultojnë dukshëm pozitive.

- *Për pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 57,64 m², në Durrës”*

21. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të padrejtë konkluzionin e Komisionit se pagesa për blerjen e pasurisë “apartament banimi në Durrës”, në shumën 1.440.000 lekë, është kryer në vitin 2005, pasi Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ, duke sjellë kjo një balancë të konsiderueshme negative, në analizën financiare për këtë pasuri.

21.1. Lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë “apartament banimi me sip. 57,64 m²”, në Durrës, Komisioni ka arsyetuar në vendim⁷, si vijon: “[...] pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ dhe, si të tilla, nuk janë marrë në konsideratë. [...] Po kështu, subjekti sjell në vëmendje faktin që e ka deklaruar këtë pronë për herë të parë në DPV-në e vitit 2007, pikërisht për shkak të likuidimit të plotë të çmimit prej tij në këtë vit, fakt që bie në kundërshtim me provat shkresore të administruara, por edhe me vetë deklaratimet e subjektit, të cilat shpesh janë jokonsistente. Në përfundim, Komisioni çmoi se subjekti nuk arriti të kundërshtojë rezultatin në lidhje me pamundësinë e pagimit të shumës prej 1.400.000 lekësh në vitin 2005. Për këtë arsye, analiza financiare e kryer në datën 09.08.2005, mbetet e pandryshuar, me një balancë negative prej 1.052.665 lekësh. Në përfundim të procesit të rivlerësimit për pasurinë apartament banimi në Durrës, u konstatua se në kuptim të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e saj dhe, për rrjedhojë, është në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarime, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.

21.2. Subjekti i rivlerësimit, në argumentimin për kundërshtimin e arsytimit dhe konkluzionit të mësipërm, ka parashtruar në ankim se Komisioni nuk ka pranuar deklarimin e bërë prej tij në deklaratat periodike të viteve 2007, 2008, 2009, si dhe në deklaratën e rivlerësimit, në të cilat ai ka deklaruar mënyrën e pagesës së çmimit të apartamentit, por e ka paraqitur situatën sikur e gjithë ngjarja e pagesave ka ndodhur në vitin 2005. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se pasuria “apartament banimi”, në Durrës, është krijuar në muajin gusht të vitit 2005, kur është rënë dakord me z. G. H., përfaqësuesin e shoqërisë “{***}” ShPK, për çmimin dhe mënyrën e pagesës. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se disa ditë më pas i ka dorëzuar z. H. shumën prej 11.500 eurosh,

⁷ Faqe 15 dhe 17 e vendimit të Komisionit.

ndërkohë që me të kishin rënë dakord që në çmim të përfshihej edhe vlera e një bankë note prej 650.000 lekësh, emetuar nga Banka e Shqipërisë, të cilën z. H. ia kishte blerë familjes së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit që në vitin 1999. Kontrata e porosisë, e cila ishte një aktmarrëveshje “tip”, si dhe mandatarkëtimi u përpiluan me qëllimin e vetëm për të marrë në dorëzim apartamentin, pasi administratori i pallatit nuk kryente veprime dorëzimi pa iu dorëzuar aktmarrëveshja dhe mandati i kryerjes së pagesës. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në fakt çmimi i plotë i apartamentit është paguar në vitin 2007, pasi në këtë vit është paguar diferenca e mbetur pa paguar, në shumën prej 840.000 lekësh. Kjo është dhe arsyeja pse subjekti i rivlerësimit, pasurinë “apartament banimi”, në Durrës, e ka deklaruar pranë ILDKPKI-së, vetëm në vitin 2007. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni i ka dhënë vlerë provuese aktmarrëveshjes së porositjes së apartamentit dhe mandatarkëtimin të datës 09.08.2005, përtej formës dhe përmbajtjes së tyre, kur në fakt ato janë akte të thjeshta shkresore të paregjistruara dhe të padeklaruara në asnjë institucion publik. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni duhet të kishte hetuar gjendjen financiare të shoqërisë “{***}” ShPK në vitin 2005, për të kuptuar nëse shuma e treguar në mandatarkëtim ishte arkëtuar apo jo brenda atij viti financiar nga shoqëria në fjalë. Sipas subjektit të rivlerësimit, pasaktësitë e tij në deklaratimet periodike të pasurisë nuk duhet të interpretohen si pamjaftueshmëri në deklaratim në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por si pasaktësi që nuk cenon besueshmërinë e deklaratimeve të bëra prej tij.

21.3. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, sa u takon pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

- Më datë 09.08.2005, z. Bari Shyti ka porositur në shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK, një apartament me sip. 63,82 m², me vlerë 2.862.000 lekë. Në kontratën e sipërmarrjes, palët kanë parashikuar një paragraf të posaçëm për mënyrën e pagesës së vlerës së sipërcituar, në të cilin, ndër të tjera, kanë rënë dakord se blerësi me lidhjen e kontratës do të paguajë tërësisht vlerën e apartamentit. Palët kanë rënë dakord, gjithashtu se kontrata merr fuqi ligjore pas kryerjes së pagesës dhe pajisjes së blerësit me mandatarkëtimin përkatës nga shoqëria sipërmarrëse.

- Në vijim të nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes dhe kryerjes së pagesës nga subjekti i rivlerësimit, shoqëria “{***}” ShPK ka lëshuar mandatarkëtimin nr. {***}, datë 09.08.2005, sipas së cilit vërtetohet se z. Bari Shyti ka paguar në arkën e shoqërisë, në datën 09.08.2005, shumën 2.862.000 lekë, me përshkrimin “likuidim apartamenti”.

- Me anë të aktdorëzimit, datë 09.08.2005, nënshkruar nga përfaqësuesi i shoqërisë sipërmarrëse dhe nga z. Bari Shyti, ky i fundit ka marrë në dorëzim apartamentin objekt i kontratës së sipërmarrjes.

- Edhe në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2012, lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së sipërcituar, është referuar se pala blerëse z. Bari Shyti deklaroi se është dakord me blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, *“apartament banimi me sip. 57,64 m² [...], me vlerën nominative të çmimit të shitjes në shumën 2.862.000 lekë, të cilën pala blerëse e ka parapaguar plotësisht jashtë kësaj zyre, fakt që pranohet edhe nga përfaqësuesi ligjor i palës shitëse dhe dokumentohet dhe me mandatarkëtimin nr. {***}, datë 09.08.2005, që i bashkëlidhet kësaj kontrate”*.

- Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar pasurinë “apartament me sipërfaqe 57,64 m²”, por nuk ka dhënë detaje mbi kohën/periudhën/momentin e kryerjes së pagesës për blerjen e tij⁸.

- Blerja e pasurisë “apartament me sipërfaqe 57,64 m²” është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të interesave të vitit 2007, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Me kursimet e deklaruara më parë dhe ato të vitit të deklarimit prej 300.000 lekësh është blerë “sipërfaqe banimi prej 32 m²”. Vendndodhja: Lagja nr. {***}, Plazh, Durrës, e paregjistruar. Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %”. Edhe në këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit nuk ka saktësuar momentin e kryerjes së pagesës, për blerjen e pjesës takuese të pasurisë.

- Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.07.2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] në vitin 2005 kam prenotuar apartamentin kundrejt çmimit 2.800.000 lekë, ku kam paguar në dorë gjysmën e çmimit prej 1.400.000 lekësh. Gjysmën tjetër prej 1.400.400 lekësh e kam paguar në vitin 2007. Kontratën e porosisë e kam bërë në emrin tim, pasi vëllai I. Sh. ndodhej jashtë shtetit dhe nuk kishte mundësi të vinte. Në vitin 2007 është paguar totalisht çmimi i apartamentit, ku gjysmën e lekëve 1.400.000 lekë e ka paguar vëllai I. Sh. dhe gjysmën tjetër e kam paguar unë”.

- Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kështu, në gusht të vitit 2005, kur u nënshkrua kontrata e sipërmarrjes dhe u mor në dorëzim apartamenti është paguar vlera 2.000.000 lekë, duke pranuar në mirëbesim për shkak të njohjes e marrëdhënieve shoqërore e familjare, që diferencën e mbetur prej 880.000 lekësh ta paguaja deri në vitin 2007. Diferenca e mbetur është paguar brenda vitit 2007”. Këtë qëndrim, subjekti i rivlerësimit e ka mbajtur edhe në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ.

21.4. Në analizë të fakteve të renditura si më lart, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e arritur nga Komisioni, në përfundim të kontrollit për pasurinë “apartament me sipërfaqe 57,64 m²”, pasi:

Së pari, siç u përshkrua në renditjen e mësipërme të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për shumat e paguara për blerjen e kësaj pasurie janë në mungesë të theksuar koherence. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumat të ndryshme për pagesën e çmimit të blerjes së pasurisë, duke krijuar konfuzion në përcaktimin e saktë të situatës reale të pagesave që kanë ndodhur mes tij dhe shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë mbështetur as nga shoqëria “{***}” ShPK, e cila në informacionin e dërguar në Komision⁹, ka konfirmuar se lidhur me marrëdhënien e saj me z. Bari Shyti, disponon dokumentacionin shkresor të përbërë nga kontrata e sipërmarrjes datë

⁸ Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “Apartament [...] me sip. 57,64 m², [...], i ndërtuar nga shoqëria “{***}” SHPK, Lagja {***}, Plazh, Durrës. Kontratë sipërmarrjeje, datë 09.08.2005. Kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2012. Çmimi: 2.862.000 lekë. Regjistruar në ZVRPP-në Durrës në datën 15.05.2012. Prenotuar në bashkëpronësi me vëllain I. Sh., duke paguar secili 50 % të çmimit. Burimi i krijimit në kohën e prenotimit për pjesën time si deklaruës prej 50 % të vlerës, janë: (i) kursime nga pagat ime dhe e bashkëshortes për periudhën 2003 – 2006; (ii) letër me vlerë e përfituar nga bashkëshortja si trashëgimtare e ish të dënuarit politik B. D. (i ati i bashkëshortes) në vlerën 650.000 lekë, shitur shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK, në vlerën 600.000 lekë, konvertuar dhe llogaritur në vlerën e kësaj pasurie. [...]”.

⁹ Informacion i përcjellë në Komision, me shkresë nr. {***} prot., datë 18.06.2019.

09.08.2005, mandatarkëtimi nr. {***}, datë 09.08.2005, akti i dorëzimit të apartamentit i datës 09.08.2005, si dhe kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2012.

Së dyti, deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të pasurisë, bien ndesh me provat e paraqitura prej tij dhe nga shoqëria sipërmarrëse, të cituara në paragrafin 21.3 më sipër, të cilat vërtetojnë se çmimi i blerjes së pasurisë është paguar tërësisht, në datën 09.08.2005.

Së fundmi, për rrjedhën e fakteve të pretenduara, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë dokumentare, por parashton vetëm shpjegimet e tij, të cilat përpiqet t'i mbështesë në deklaratimet e bëra në deklaratën e rivlerësimit dhe atë të interesave të vitit 2007, por siç është shtjelluar edhe më herët, në asnjërin prej këtyre deklarimeve, subjekti i rivlerësimit nuk ka saktësuar momentin dhe mënyrën e kryerjes së pagesës, për blerjen e pasurisë objekt kontrolli.

21.5. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni i ka dhënë vlerë provuese aktmarrëveshjes së porositjes së apartamentit dhe mandatarkëtimit të datës 09.08.2005, përtej formës dhe përmbajtjes së tyre, kur në fakt ato janë akte të thjeshta shkresore të pargjistruara dhe të padeklaruara në asnjë institucion publik, kundërshtohet nga fakti i pakontestueshëm se subjekti i rivlerësimit dhe shitësi kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2012, në të cilën të dy palët kanë rënë dakord që çmimi është *parapaguar plotësisht jashtë zyrës noteriale, dokumentuar dhe me mandatarkëtimin nr. {***}, datë 09.08.2005, që i bashkëlidhet kontratës*. Në kushtet kur deklaratimet e subjektit të rivlerësimit kontestojnë çfarë ai vetë ka dakordësuar në kontratën e shitblerjes së pasurisë objekt kontrolli, të nënshkruar në prani të noterit publik, trupi gjykues çmon se kjo situatë, më së paku, krijon perceptimin se subjekti i rivlerësimit konteston vërtetësinë e fakteve të referuara në këtë kontratë, me anë të së cilës ai ka fituar pronësinë e pasurisë dhe e ka regjistruar atë në emër të tij në regjistrat publikë. Mospërputhjet mes deklarimeve të subjektit në deklaratën e rivlerësimit, deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit dhe përmbajtjes së akteve të kohës - kontratës së sipërmarrjes dhe kontratës së shitblerjes - nuk bindën trupin gjykues për vërtetësinë e pretendimeve të tij, për pasojë u gjet i drejtë qëndrimi i Komisionit, që ka konsideruar si datë të kryerjes së pagesës për blerjen e pjesës takuese të pasurisë “apartament me sipërfaqe 57,64 m²”, datën 09.08.2005 dhe kryerjen e analizës financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit i rivlerësimit për kryerjen e kësaj pagese me burime të ligjshme financiare, deri në këtë datë.

21.6. Trupi gjykues e gjeti të pabazuar në fakte edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka bërë hetime të mjaftueshme për të verifikuar gjendjen financiare të shoqërisë “{***}” ShPK, në vitin 2005, për të kuptuar nëse shuma e treguar në mandatarkëtim ishte arkëtuar apo jo brenda atij viti financiar nga shoqëria në fjalë. Trupi gjykues vëren se Komisioni ka administruar mjaftueshëm të dhëna që provojnë momentin e likuidimit të çmimit të pasurisë objekt kontrolli nga subjekti i rivlerësimit, të cilat burojnë nga aktet shkresore të kohës, të dakordësuara e të nënshkruara nga vetë subjekti e që nuk janë kundërshtuar nga pala tjetër kontraktore, shoqëria sipërmarrëse. Për më tepër, në procesin e rivlerësimit, bazuar në nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, barra e provës, për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën

e rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në rastin konkret nuk e ka shfrytëzuar mundësinë që i ka dhënë parashikimi ligjor.

21.7. Në vijim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni, konstatoi se konfirmohet konkluzioni i arritur nga ky i fundit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 57,64 m²”, në shumën (-) 1.052.665 lekë, duke u gjendur, për pasojë në kushtet e parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Sa i përket konkluzionit të Komisionit se në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 57,64 m²”, në Durrës, nga verifikimi i arsytimit të vendimit, trupi gjykues vëren se Komisioni ka arritur në këtë përfundim, për shkak të mosdeklarimeve nga ana e subjektit në deklaratën e interesave të vitit 2005 dhe në atë të vitit 2006, të lidhjes së kontratës së sipërmarrjes së datës 09.08.2005, si dhe marrjes në dorëzim të apartamentit. Sipas arsytimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e deklarimit të pasurisë në deklaratat e viteve 2005 dhe 2006, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), i cili parashikon se subjektet kanë detyrimin e deklarimit të pasurisë, të drejtave reale, pakësimet e depozitave apo gjendjeve *cash*, si dhe burimin e krijimit¹⁰. Në zbatim të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, në kushtet kur këto pasaktësi konstatohen në deklaratat periodike të interesave, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk mund të ngrihen në nivelin e pasaktësive që prodhojnë një shkelje të tillë, për të justifikuar masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

- Për pasurinë “Apartment banimi me sipërfaqe 107 m², në Tiranë

22. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, shuma 21.000 USD e siguruar nga puna e tij dhe e bashkëshortes në grumbullimin e mineralit të kromit, është e ardhur e ligjshme dhe, për rrjedhojë, edhe pasuria “apartament banimi”, në Tiranë, e krijuar me këtë të ardhur është pasuri e ligjshme.

22.1. Lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të të ardhurës në shumën 21.000 USD, e cila është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit si një nga burimet e krijimit të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendim¹¹, si më poshtë.

Për sa i takon ligjshmërisë së burimit të shumës 21.000 USD, [...] kjo shumë nuk u konsiderua si e ardhur e ligjshme që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, referuar fakteve si vijojnë: i) Subjekti dhe/ose bashkëshortja nuk janë regjistruar në gjykatë për ushtrimin e aktivitetit të mbledhjes së 60 ton krom, sikurse përcaktohet nga ligji, veprim i cili do ta kualifikonte shumën 21.000 USD si të ardhur të ligjshme; ii) Subjekti nuk arriti të justifikojë

¹⁰ Paragrafi 1.8.1. i vendimit të Komisionit.

¹¹ Faqe 25 e vendimit të Komisionit.

*bindshëm arsyet e mosdeklarimit të kësaj shume të marrë cash nga shoqëria “{***}” ShPK, në vitin 2008, të pretenduar të mbartur cash në DPV-në për vitet 2008 dhe 2009 dhe përdorur në vitin 2010. [...] Në vijim të qasjes së subjektit dhe logjikës që përdor në argumentim, edhe nëse do të merrej e mirëqenë që në fund të vitit 2009 subjekti e ka pasur likuiditetin cash në vlerën 21.000 USD, në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit pakësimin e këtij likuiditeti për shkak të pagesës së këstit prej 35.000 euro për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi. Për më tepër, likuiditeti në shumën 21.000 USD nuk është përmendur në këtë deklaratë si burim i përdorur për pagimin e këstit 35.000 euro, burim i cili është deklaruar për herë të parë në deklaratën Vetting. Për këto arsye, gjendja cash është konsideruar nga Komisioni, sikurse është deklaruar në DPV-të ndër vite nga subjekti, pasi çdo pretendim i paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit mbetet në nivel deklarativ. [...] Po kështu, vetëm në rastin kur subjekti do të plotësonte në mënyrë akumulative dy kushte, së pari të vërtetonte legjitimitetin e shumës 21.000 USD, deklaruar si e ardhur në DPV-në e vitit 2008 dhe së dyti, të kishte kryer deklarime të sakta në lidhje me gjendjen e likuiditetit cash prej 21.000 USD në DPV-në e viteve 2008 dhe 2009 dhe pakësimin e tij në vitin 2010, kjo shumë do të konsiderohej si burim i ligjshëm në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për të gjitha sa më sipërrasytuar, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se subjekti ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në lidhje me shumën 21.000 USD, e cila nuk u konsiderua burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë apartament banimi, në rrugën “{***}”, Tiranë.*

22.2. Pas kontrollit të arsyetimit të Komisionit në vendim, lidhur me ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 21.000 USD, trupi gjykues vëren se konkluzionin se pse kjo shumë nuk u konsiderua si e ardhur e ligjshme që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, Komisioni e ka bazuar në argumentin se subjekti i rivlerësimit dhe/ose bashkëshortja nuk janë regjistruar në gjykatë për ushtrimin e aktivitetit të mbledhjes së 60 ton krom, sikurse përcaktohet nga ligji, veprim i cili do ta kualifikonte shumën 21.000 USD si të ardhur të ligjshme. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në rastin konkret nuk ka vend për të diskutuar për regjistrim apo ushtrim aktiviteti të mbledhjes së mineralit të kromit pa licencë, pasi bëhej fjalë për një punë fizike për llogari të një subjekti të regjistruar rregullisht siç ishte shoqëria “{***}” ShPK. Detyrimet fiskale, të cilat janë të pashmangshme edhe për shkak të natyrës së mallit, janë paguar të gjitha nga shoqëria “{***}” ShPK, e licencuar në aktivitetin minerar, për pasojë subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se e ardhura në shumën 21.000 USD është e ardhur e ligjshme, në kuptim të parashikimeve ligjore të procesit të rivlerësimit.

22.3. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, nga verifikimi i akteve të administruara nga hetimi i kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se:

- Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur deklaratën e z. I. Sh., ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, datë 11.12.2014, i cili ka deklaruar se: “Në vitin 2008 edhe vëllai im Bari Shyti ka punuar me familjen e tij dhe me persona të paguar prej tij, ku ka prodhuar në stokun e galerisë së shoqërisë “{***}” ShPK, rreth një kamion mineral kromi. Minerali është shitur nga unë, duke i kthyer vlerën e plotë, duke zbritur tatim fitimin, i cili është paguar nga unë në momentin e shitjes së mineralit të shoqëritë e tjera eksportuese dhe rentën minerare, e cila paguhet nga shoqëria për çdo shitje”. Të njëjtin deklaram z. I. Sh. e ka bërë edhe

në shkresën nr. {***} prot. {***}, datë 03.08.2017, të shoqërisë “{***}” ShPK, drejtuar ILDKPKI-së, në përgjigje të hetimit të zhvilluar nga ky institucion.

• Administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, z. I. Sh., ka informuar Komisionin¹² se: *“Duke qenë se vëllai im Bari Shyti ishte pa punë për shkak se u mbyll Gjykata e Bulqizës, ku ai punonte si gjyqtar, i ofrova mundësinë që vetë me familjen e tij apo duke organizuar një grup pune me shpenzimet e tij të mblidhte mineral kromi, në stokun e sterilëve të objektit tim minerar [...]. Sa për sqarim, kjo është një punë që kryhet në sipërfaqe (jo nëntokë) nga kushdo, madje në minierë konsiderohet si punë e lehtë [...]. Pikërisht këtë punë ka kryer vëllai Bari Shyti, i cili me familjen e tij dhe me sa mbaj mend edhe duke organizuar grupe në ditë të veçanta, gjatë vitit 2008, ka grumbulluar një sasi mineral kromi sa një kamion i tonazhit të rëndë, rreth 50-70 ton. Këtë sasi minerali e kam shitur unë si subjekt i licencuar në fushën minerare, ku nga çmimi i shitjes janë mbajtur vetëm detyrimet fiskale, çmimi i transportit dhe çdo shpenzim tjetër deri në ngarkimin në anije, sikurse veprohet në çdo rast tjetër. [...] Pasi është shitur nga shoqëria “{***}” ShPK nëpërmjet eksportit gjithë sasia e kromit e mbledhur gjatë vitit 2008, duke kapur çmimin më të lartë, ku në sasinë e grumbulluar përfshihej edhe sasia e mbledhur nga vëllai Bari Shyti [...], çmimi i shitjes, pasi janë zbritur detyrimet që rëndojnë mbi shoqërinë, i është paguar në cash në monedhën USD vëllait Bari Shyti, pasi kjo shumë është tërhequr nga llogaria ime në Alpha Bank, në cash. Nuk mund të kujtoj me detaje shumën që i kam paguar, por shuma e deklaruar prej tij 21.000 USD, nga ku del se çmimi për (1) ton i takon të jetë 350 USD, është çmimi normal për kohën, që përfaqëson afërsisht edhe çmimin e blerjes së këtij minerali në tregun informal. [...] Theksojmë se mbajtja e tatimit në burim për këtë lloj transaksioni nuk parashikohet nga neni 33 i ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, gjithsesi, subjektit i është mbajtur në çmim çdo detyrim fiskal për t’u paguar nga ana e shoqërisë”.*

- Shoqëria “{***}” ShPK ka përcjellë pranë Komisionit, edhe aktet:
 - Faturë tatimore shitje nr. {***}, datë 31.07.2008, për shitjen e 450 ton krom nga shoqëria “{***}” ShPK, me vlerë me TVSh, *neto* 205.221 USD;
 - Deklaratë doganore, datë 31.07.2008, për eksportimin e 450 ton krom nga shoqëria “{***}” ShPK;
 - Të dhënat bankare nga Alpha Bank, ku pasqyrohen arkëtimet nga shoqëria “{***}” ShPK nga shitja e 450 ton krom, si dhe tërheqje *cash* në shumën 167.940 USD, nga data 09.04.2008-24.12.2008, periudhë gjatë së cilës janë bërë dhe pagesat për znj. E. Sh.;
 - Disa fletëhyrje magazine me data të ndryshme, me vulën e shoqërisë “{***}” SHPK, ku cilësohet se znj. E. Sh. ka dorëzuar nga grumbullimi në stokun e shoqërisë 60 ton krom gjithsej, për periudhën mars-korrik 2008;
 - Mandatpagesa në shuma të ndryshme lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, kundrejt znj. E. Sh.¹³, për periudhën prill-dhjetor 2008, në shumën totale prej 21.000 USD.

¹² Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.06.2019.

¹³ Mandatpagesë nr. {***}, datë 10.04.2008, të shoqërisë “{***}” ShPK, për znj. E. Sh., për “Grumbullim mineral kromi”, në shumën 2.000 USD, në nënshkruar nga financieri P. D., marrësi E. Sh. dhe dhënësi I. Sh.; Mandatpagesë nr. {***}, datë 15.07.2008, të shoqërisë “{***}” ShPK, për znj. E. Sh., për “Grumbullim mineral kromi”, në shumën 3.000 USD, në nënshkruar nga financieri P. D., marrësi E. Sh. dhe dhënësi I. Sh.; Mandatpagesë nr. {***}, datë 25.08.2008, të shoqërisë “{***}” ShPK, për znj. E. Sh., për “Grumbullim mineral kromi”, në shumën 7.000 USD, në

22.4. Komisioni, me shkresë nr. {***} prot., datë 14.12.2020, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke i kërkuar informacion, lidhur me: *“A do të duhej të paguhej tatim në burim për shumat e paguara nga shoqëria “{***}” ShPK gjatë vitit 2008 ndaj znj. E. Sh.? Kujt i takon detyrimi ligjor për të paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga mbledhja e kromit prej znj. E. Sh.? A janë paguar detyrimet tatimore për shumën 21.000 USD të përfituar gjatë vitit 2008 nga znj. E. Sh.?”*

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresë nr. {***} prot., datë 21.01.2021, ka informuar Komisionin, se: *“[...] për të ardhurat e përfituara nga individët nga grumbullimi i kromit 60 ton, nuk do të mbahej tatim në burim, por ata duhet të regjistroheshin në gjykatë për ushtrimin e aktivitetit, sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.*

22.5. Në analizë të pretendimeve të subjektit, në raport me situatën faktike dhe arsyetimin e Komisionit, trupi gjykues vëren se dokumentacioni justifikues i dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, nuk arrin të qartësojë llojin e marrëdhënies juridike që ka ekzistuar mes subjektit të rivlerësimit e bashkëshortes së tij dhe kësaj shoqërie tregtare, nëse është një marrëdhënie pune apo një marrëdhënie tjetër, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës apo parashikimeve të Kodit Civil, pasi nuk ka një akt që të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet reciproke mes palëve. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se është e paqartë dhe cilësia në të cilën znj. E. Sh. ka dorëzuar në magazinat e shoqërisë “{***}” ShPK, kundrejt pagesës, 60 ton mineral krom dhe, me këtë rast, janë lëshuar dhe mandatpagesat përkatëse në emër të saj, në vlerën totale prej 21.000 USD. Subjekti i rivlerësimit nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë “{***}” ShPK. Në periudhën tetor 2007-korrik 2008 ekziston një marrëdhënie punësimi mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe bashkëshortes së tij, znj. E. Sh., e cila, sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 27.10.2016, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Bulqizë “Për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për E. Sh. për periudhën 01.10.2007-30.06.2008”, ka përfituar nga shoqëria “{***}” ShPK, në vitin 2007 paga *neto*, në shumën 42.624 lekë dhe në vitin 2008 paga *neto*, në shumën 85.248 lekë. Sipas formularëve të dorëzuar nga shoqëria pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Bulqizë, znj. Sh. është deklaruar si punëtore pranë kësaj shoqërie, ndërsa administratori i saj, në deklaratat e tij, ka pranuar se znj. Sh. ka punuar si llogaritare. Pavarësisht këtyre fakteve, të cilat referojnë se znj. Sh. në kohën e punësimit si llogaritare pranë shoqërisë “{***}” ShPK duket se ka punuar edhe si grumbulluese e mineralit të kromit në stokun e kësaj shoqërie, administratori i shoqërisë, z. I. Sh., nuk ka deklaruar asnjëherë se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka punuar si e tillë. Administratori i shoqërisë, z. I. Sh., ka theksuar se duke qenë se vëllai i tij Bari Shyti ishte pa punë për shkak se u mbyll Gjykata e Bulqizës, ku ai punonte si gjyqtar, i ofroi mundësinë që vetë me familjen e tij apo duke organizuar një grup pune me shpenzimet e tij, të mblidhte mineral kromi,

*nënshkruar nga financieri P. D., marrësi E. Sh. dhe dhënësi I. Sh.; Mandatpagesë nr. {***}, datë 16.09.2008, të shoqërisë “{***}” ShPK, për znj. E. Sh., për “Grumbullim mineral kromi”, në shumën 3.000 USD, në nënshkruar nga financieri P. D., marrësi E. Sh. dhe dhënësi I. Sh.; Mandatpagesë nr. {***}, datë 24.12.2008, të shoqërisë “{***}” ShPK, për znj. E. Sh., për “Grumbullim mineral kromi”, në shumën 6.000 USD, në nënshkruar nga financieri P. D., marrësi E. Sh. dhe dhënësi I. Sh..*

në stokun e sterilëve të objektit mineralar të shoqërisë “{***}” ShPK. Edhe vetë subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave të vitit 2008, e cila jo vetëm shërben si provë në këtë proces¹⁴, por edhe është deklarata e kohës kur ka ndodhur aktiviteti i pretenduar, ka deklaruar se shuma prej 21.000 USD është përfituar nga *mbledhja dhe shitja e mineralit të kromit rreth 60 ton krom në stokun e firmës “{***}” ShPK*. Nga hetimi i zhvilluar nga ILDKPKI-ja, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk figurojnë të regjistruar në sistemin tatimor.

22.6. Trupi gjykues analizoi faktet dhe rrethanat e konstatuara si më sipër dhe vlerësoi në harmoni si vijon.

i) Referuar ligjit nr. 7706, datë 17.02.1994, “Ligji mineralar i Shqipërisë”, i cili përbënte kuadrin ligjor të kohës për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe personave juridikë dhe fizikë, me qëllim që këta të fundit të përfitonin të drejtat minerare dhe të ekzekutonin aktivitetet minerare, në nenin 3, parashikohej dhënia, nga autoriteti shtetëror përgjegjës, e lejes minerare, e cila nënkuptonte të drejtën e dhënë në përputhje me këtë ligj, për t’u futur në aktivitete që lidhen me kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve. Në vijim, sipas nenit 9 të këtij ligji: “Shteti u jep të drejtat minerare në përputhje me këtë ligj, personave fizikë ose juridikë vendas ose të huaj, duke i lejuar zotëruesit të së drejtës minerare të kryejë aktivitetet minerare. Asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitetet minerar përveç atyre që zotërojnë të drejtat e siguruara nga ky ligj”. Referuar përmbajtjes së dispozitave sipërcituar, trupi gjykues vëren se asnjë lloj aktiviteti mineralar nuk mund të ushtrohet nga personat juridikë apo fizikë, në rast se këta të fundit nuk ishin të pajisur me leje për të zotëruar të drejtat përkatëse për ushtrimin e aktivitetit mineralar. Sipas përcaktimeve ligjore, lejet minerare iu jepeshin vetëm subjekteve tregtarë, personave fizikë ose juridikë (nenet 53 dhe 55 të ligjit nr. 7706, datë 17.02.1994, “Ligji mineralar i Shqipërisë”). Në përjashtë të situatës faktike të sipërcituar, me parashikimet e legjislacionit mineralar të kohës, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mund të ushtronin aktivitetet minerar të çfarëdollojti, aq më tepër grumbullimin e shitjen e mineralit të kromit, pasi kjo e drejtë i njihet vetëm subjekteve tregtarë të pajisur me lejet minerare përkatëse. Për pasojë, veprimtaria e pretenduar si e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij konsiderohet nga trupi gjykues një veprimtari e paregjistruar dhe e palicencuar nga organet përkatëse shtetërore.

ii) Edhe nëse znj. Sh., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, do të kishte punuar si punëtoare e grumbullimit të mineralit të kromit në shoqërinë “{***}” ShPK, ndërkohë që punonte edhe si llogaritare pranë kësaj shoqërie, mundësia për t’u paguar në shumën prej 21.000 USD, një shumë përgjithësisht me një efekt ndikues në jetesën e një individi, për një punë të kryer vetëm për periudhën mars-korrik 2008, del jashtë një vlerësimi logjik e të arsyeshëm brenda kontekstit të marrëdhënieve të punës e sidomos në realitetin e punës në minierë, në zonën e Bulqizës.

iii) Në kontekstin e marrëdhënieve të punës në stokun e një miniere, duket e pabesueshme që vetëm dy individë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, të kenë grumbulluar 60 ton mineral krom, në një periudhë të shkurtër kohore, prej 6 muajsh.

¹⁴ Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit”.

Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se të gjitha këto rrethana vënë në dyshim kryerjen realisht të veprimtarisë së grumbullimit dhe shitjes së mineralit të kromit nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij dhe, për rrjedhojë, nuk krijojnë bindjen se kjo e ardhur është përfituar prej tyre.

22.7. Duke abstraguar nga konkluzioni i mësipërm, sa i takon pagesës së detyrimeve tatimore, nga deklaratat e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK të lëshuara për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se sipas fletëhyrjeve të dorëzimit të mineralit në magazinën e shoqërisë “{***}” ShPK, minerali i grumbulluar i kromit është dorëzuar nga znj. E. Sh., në periudhën mars-korrik 2008. Sipas mandatpagesave, për mineralin e dorëzuar ajo është paguar nga shoqëria në shuma të ndryshme në muajt prill, korrik, gusht, shtator dhe dhjetor 2008, ndërkohë që sipas të dhënave të faturës tatimore të shitjes, shoqëria “{***}” ShPK ka shitur sasinë prej 450 ton të mineralit të kromit në datën 31.07.2008. Në mbështetje të këtyre fakteve, rezulton se shoqëria “{***}” ShPK ka shlyer detyrimet tatimore që i përkasin asaj, për efekt të ushtrimit të aktivitetit për të cilin është pajisur me lejen përkatëse minerare dhe jo detyrimet tatimore që i përkasin subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, si individë që kishin realizuar të ardhura nga shitja e një sasive të konsiderueshme mineral kromi.

Referuar legjislacionit tatimor të kohës, trupi gjykues vëren se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshimet përkatëse deri në dhjetor të vitit 2008, në nenin 33 “Tatimi i mbajtur në burimin e të ardhurave”, në pikën 1, shkronja “c”, përcaktonte detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim nga shuma *bruto* e pagesave që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë, siç janë pagesat për shërbimet teknike, etj.

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 31.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në pikën 5.2, shkronja “c”, parashikonte: “5.2 Tatimi në burim nuk do të mbahet kur pagesa i bëhet: [...] c. personave fizikë tregtarë, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin kur pagesa është për shërbime që përbëjnë aktivitetin normal të biznesit të tyre. Këtu do të përfshihen dhe personat fizikë tregtarë që merren me grumbullimin e mbetjeve të metaleve, grumbullimit të bimëve mjekësore, grumbullimin e qumështit, ullirit, rrushit, shishe, etj.”. Sipas këtij parashikimi ligjor, mosmbajtja e tatimit në burim ndodh vetëm në rast se grumbullimi i mbetjeve të metaleve kryhet nga persona fizikë tregtarë. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë qenë subjekte tregtare, por kanë vepruar si individë. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se edhe nëse do të ishte përfituar e ardhura e pretenduar në shumën prej 21.000 USD nga grumbullimi dhe shitja e 60 ton krom, ajo nuk mund të konsiderohet e ardhur e ligjshme, pasi për të nuk janë paguar detyrimet tatimore.

22.8. Në përfundim, mbështetur në gjithë analizën e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk justifikuan ligjshmërinë e krijimit të së ardhurës në shumën 21.000 USD, e pretenduar se është përfituar nga grumbullimi dhe shitja e 60 ton mineral krom, në kuptim të parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi ata nuk ishin të regjistruar si tregtarë dhe nuk ishin të pajisur me leje minerare për të zhvilluar aktivitet minerar. Për rrjedhojë, kjo shumë nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për financimin e krijimit të pasurisë “apartment banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë dhe, si e tillë, nuk mund të përfshihet në burimet e ligjshme në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie.

22.9. Në vijim të konkluzionit të arritur si më sipër, sipas së cilit shuma prej 21.000 USD nuk u konsiderua e ardhur e ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me mosdeklarimin e kësaj shume si gjendje *cash* në fund të vitit 2008, nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht këtij qëndrimi, trupi gjykues, në verifikim të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave, për vitet 2008-2010, e gjeti të drejtë vlerësimin e Komisionit se kjo shumë nuk rezultoi e deklaruar saktësisht si shtim i likuiditetit në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në deklaratën periodike të vitit 2008, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003.

23. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, shuma 18.500 euro është e ardhur nga burime të ligjshme për të cilat janë dhënë deklarime bindëse dhe të mjaftueshme dhe, për rrjedhojë, edhe pasuria apartament banimi në Tiranë, e krijuar me këtë të ardhur, është pasuri e ligjshme, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

23.1. Lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurës në shumën 18.500 euro, e cila është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit si një nga burimet e krijimit të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendim¹⁵: *[...] Komisioni nuk e ka mohuar të ardhurën në shumën 18.500 euro, pasi subjekti ka deklaruar në DPV-në për vitin 2010, shitjen e 50% pjesë takuese nga ana e të vëllait I. Sh., në vlerën 18.500 euro. Kështu, në një kuptim, subjekti e ka deklaruar këtë shumë si të ardhur, por nuk e ka deklaruar këtë shumë si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, sipas së cilit subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë burimin e krijimit të çdo pasurie, në rastin konkret, burimin për pagesën e kështit prej 35.000 euro, në vitin 2010. Këtë burim e ka deklaruar vetëm në deklaratën vetting. Nga ana tjetër nuk ka vërtetuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj të ardhure. Për këto arsye, shuma prej 18.500 eurosh nuk është përfshirë si e ardhur ligjore në analizën përfundimtare financiare. Sa i takon pretendimit se marrëdhënia e tij me vëllain I. Sh. nuk është një marrëdhënie huaje apo dhurimi e, për këtë shkak, nuk i takon barra e provës për të vërtetuar burimin e të ardhurave të bashkëpronarit që pranon të blejë pjesën e tij takuese, Komisioni e ka vlerësuar si të pabazuar, duke konsideruar vëllain e subjektit të rivlerësimit si person tjetër të lidhur, sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016.*

23.2. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se z. I. Sh. është konsideruar nga Komisioni si person tjetër i lidhur, në mënyrë të padrejtë, pasi me të subjekti ka pasur gjithmonë një marrëdhënie bashkëpronësie, por asnjëherë marrëdhënie biznesi apo interesi në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, nisur nga fakti i provuar se ai ka marrë përsipër t'i kthejë vëllait të tij shumat e paguara në vitin 2005 për pjesën 50% të apartamentit në Durrës dhe më pas në vitin 2010 për blerjen edhe të pjesës tjetër, duke u bërë vëllai pronari *de facto* i 100% të pasurisë, të drejtë të cilën e ka ushtruar deri në vitin 2012, borxh ky i lindur mbi

¹⁵ Faqe 29 e vendimit të Komisionit.

një marrëdhënie pronësie dhe aktualisht i paguar nga subjekti, nuk mund të shndërrojë marrëdhënien *de facto* të pronësisë mes tyre, në një marrëdhënie tjetër pasurore si huadhënia e, për pasojë, z. I. Sh. të konsiderohet person tjetër i lidhur. Ajo ka qenë dhe mbetet një marrëdhënie pronësie dhe as në kohën kur është dhënë shuma prej 18.500 eurosh, si çmim për blerjen e 50 % të apartamentit, as në kohën kur subjekti ka deklaruar se ka marrë përsipër të kthejë gjithë shumën e paguar për këtë pasuri, nuk ka asnjë element të huas, huapërdorjes, aq më pak të dhurimit, sikundër orvatet ta interpretojë Komisioni, pasi as nuk ka ekzistuar një vullnet i tillë. Në thelb të deklaratës noteriale të datës 13.07.2012 qëndron pikërisht marrja përsipër nga ana e subjektit e detyrimit për t'i kthyer z. I. Sh. shumën e paguar prej tij deri në vitin 2012, kur ky i fundit nuk ka pranuar të lidhë kontratën e shitblerjes së apartamentit me arsyetimin se nuk i plotësonte kushtet që ai kërkonte.

23.3. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, sa u takon pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

- Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, shumën prej 18.500 eurosh, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, edhe “[...] premtim shitjeje e pjesës prej 50 % e apartamentit në Lagjen {***}, Plazh, Durrës, bashkëpronarit të pjesës prej 50% I. Sh., kundrejt vlerës 18.500 euro”. Kjo shumë është deklaruar për herë të parë në deklaratën e rivlerësimit, si burim krijimi për pasurinë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, pasi në deklaratat periodike të interesave, subjekti nuk e ka deklaruar këtë vlerë në burimet e krijimit të pasurisë apartament në Tiranë.

- Më datë 09.08.2005, z. Bari Shyti ka porositur në shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK, një apartament banimi me sip. 63,82 m², në Durrës, me vlerë 2.862.000 lekë, shumë e paguar tërësisht nga subjekti i rivlerësimit, sipas mandatarkëtimit nr. {***}, datë 09.08.2005. Kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2012, është lidhur mes subjektit dhe shoqërisë së sipërcituar më datë 02.04.2012 dhe apartamenti është regjistruar në emër të subjektit në ZVRPP-në Durrës, më datë 15.05.2012.

- Në datën 13.07.2012, subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij, z. I. Sh., kanë redaktuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., në të cilën kanë deklaruar marrëdhënien e tyre lidhur me pasurinë “apartament banimi me sip. 63,82 m²”, në Durrës¹⁶. Përmbajtja e kësaj

¹⁶ Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.07.2012, subjekti dhe vëllai i tij, z. I. Sh., kanë deklaruar përkatësisht:

Deklaruesi I. Sh.: “[...] në vitin 2005 kam rënë dakord me vëllain tim Bari Shyti që të blinim bashkërisht një apartament banimi në lagjen Plazh, Durrës, me qëllim përdorimin e saj për pushimet verore. Meqenëse unë isha emigrant në Belgjikë dhe e kisha të pamundur të vija në Shqipëri për shkak të mungesës së dokumenteve, kam porositur vëllain tim Bariun, që të bënte porosinë e apartamentit dhe unë t'i dërgoja gjysmën e çmimit. Në gusht të vitit 2005 jam njoftuar nga Bariu se ka prenotuar një apartament në Lagjen Plazh, Durrës, me çmim total 2.800.000 lekë të reja. Sipas kërkesës së tij i kam dërguar 11.500 euro për të paguar gjysmën e çmimit. Në vitin 2010 njoftohem nga vëllai se kërkon të shesë pjesën e tij të apartamentit, pasi kishte prenotuar një apartament tjetër në Tiranë. Pasi ramë dakord për çmimin, pranova të blej pjesën e tij kundrejt vlerës 18.500 euro. Kjo rritje e çmimit nga 11.500 sipas shitësit Bari Shyti ka ardhur si pasojë e rritjes së vlerës së tregut të banesave. Në vitin 2010 i kam dërguar dorazi shumën prej 18.500 euro dhe apartamenti do të ishte totalisht pasuri e imja. Në mars të vitit 2012 kam ardhur në Shqipëri dhe kam parë apartamentin, pasi duhej të bëja regjistrimin e tij në emrin tim pranë ZVRPP-së Durrës, kam

deklarate është konfirmuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të drejtuar nga Komisioni.

- Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Me kursimet e deklaruara më parë dhe ato të vitit të deklarimit prej 300.000 lekësh është blerë “sipërfaqe banimi prej 32 m²”. Vendndodhja: Lagja nr. {***}, Plazh, Durrës, e paregjistruar. Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %*”.

- Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2008, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, është deklaruar: “*Kontratë provizore me “{***}” ShPK, për blerje shtëpie pushimi në L. {***}, Plazh, Durrës, me sip. 32 m² (1/2 e 64 m²), shtator 2005*”. Në po këtë rubrikë, është deklaruar lidhja me vëllain I. Sh. dhe lloji i interesit privat “bashkëpronësi në banesën shtëpi pushimi me sip. 64 m², plazh”. I njëjti deklaram është bërë edhe në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009.

- Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Shitur pjesa 50 % e apartamentit në Lagjen nr. {***}, Plazh, Durrës. Pjesën e ka blerë vëllai I. Sh., i cili dispononte pjesën tjetër prej 50 %, me sip. 32 m², në vlerën 18.500 euro*”. I njëjti deklaram është bërë edhe në deklaratën periodike të interesave të vitit 2011.

- Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament 1+1, vendndodhja: Lagja nr. {***}, Plazh, Durrës. Kjo pasuri është krijuar në vitin 2005 si pronë e përbashkët ndërmjet meje dhe shtetasit I. Sh., vëllait. Pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Durrës në emrin tim, në vitin 2012. Vlera: 2.872.000 lekë*”.

Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë” të këtij deklarimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Detyrim financiar i lindur në vitin 2012 ndërmjet meje dhe vëllait I. Sh. për shkak të marrjes përsipër nga ana ime të vlerës së apartamentit 1+1 në Lagjen nr. {***}, Plazh, të paguar më parë nga I. Sh.. Afati i shlyerjes për tre vjet me këste vjetore nga 10.000 euro për çdo vit, në vlerën 27.500 euro*”.

Në deklaratat periodike të interesave të viteve në vazhdim 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka vijuar me deklarimin e shlyerjes së detyrimit ndaj vëllait të tij, z. I. Sh., në vlerat përkatëse.

- Nga të dhënat bankare të përcjella në Komision nga Raiffeisen Bank është vërtetuar se nga llogaria rrjedhëse e subjektit të rivlerësimit, gjatë vitit 2014, ka kaluar shuma 3.500.000 lekë, përmes tri transfertave, me përshkrim “Kthim borxhi Bari Shyti në emër të z. I. Sh.”.

konstatuar se apartamenti nuk i plotësonte kërkesat e mia. Për këtë arsye bisedova me vëllain Bari Shyti dhe i kërkoja që të më kthente shumën e lekëve që i kam dhënë dhe unë të heq dorë nga kjo pasuri”.

Deklaruesi Bari Shyti, subjekti i rivlerësimit: “[...]në vitin 2005 kam prenotuar apartamentin kundrejt çmimit 2.800.000 lekë të reja [...] Në vitin 2010 kam prenotuar një apartament banimi në Tiranë dhe për këtë shkak kërkoja nga vëllai të blinte pjesën time të apartamentit kundrejt vlerës 18.500 euro. Kjo bisedë është zhvilluar në telefon, ku kemi rënë dakord dhe në mars-prill të vitit 2010 kam marrë nga I. Sh. shumën prej 18.500 euro. Në vitin 2012 vëllai I. Sh. ka ardhur në Shqipëri dhe pasi ka parë apartamentin nuk ka pranuar të marrë çelësat e tij dhe të bëjë regjistrimin në emër të tij. Për sa më sipër, jam dakord që vëllai I. Sh. të heqë dorë nga pasuria apartament banimi me sip. 64 m², i cili ndodhet në Lagjen Plazh, Durrës dhe me heqjen dorë të tij unë marr përsipër t’i kthej shumën e paguar prej 30.000 euro. Marr përsipër detyrimin që këtë shumë t’ia kthej shtetasit I. Sh. me këste, duke i paguar në datën 31.12.2013 shumën prej 10.000 euro, në datën 31.12.2014 shumën prej 10.000 euro, dhe në datën 31.12.2015 shumën prej 10.000 euro. Pas datës 31.12.2015, nëse shuma prej 30.000 euro nuk i paguhet totalisht ose pjesërisht shtetasit I. Sh., pjesa e mbetur pa paguar do të rëndohet me interes 1.5 % për çdo muaj vonesë”.

- Në deklaratën e rivlerësimit, subjekti ka deklaruar detyrimin financiar në shumën 1.800 euro, ndaj vëllait të tij z. I. Sh..

23.4. Në analizë të shkakut të ankimit, pas kontrollit të arsyetimit në vendim lidhur me ligjshmërinë e shumës prej 18.500 eurosh, trupi gjykues vëren se Komisioni e ka pranuar këtë shumë si të ardhur të subjektit të rivlerësimit, por nuk e ka konsideruar si të ardhur të ligjshme. Konkluzionin se kjo shumë nuk u konsiderua si e ardhur e ligjshme për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, Komisioni e ka bazuar në argumentet: (i) subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë shumë si të ardhur, por nuk e ka deklaruar atë si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, në vitin 2010, por vetëm në deklaratën e rivlerësimit; dhe (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj të ardhure nga vëllai i tij, z. I. Sh., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016.

23.4.1 Lidhur me argumentin e parë të përdorur nga Komisioni, në moskonsiderimin e shumës prej 18.500 eurosh si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, në analizë të situatës faktike të pasqyruar në paragrafin 23.3 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues konstatoi se kjo shumë është deklaruar si burim krijimi për pasurinë objekt kontrolli, për herë të parë në deklaratën e rivlerësimit, pasi në deklaratat periodike të interesave në vitet 2010 dhe 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimet financiare të pagesave përkatëse për blerjen e kësaj pasurie. Në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, konkretisht parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, për efekt të procesit të rivlerësimit, objekt i kontrollit janë pasuritë për të cilat subjekti mbarte detyrimin për t’i deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe që janë relevante në këtë proces dhe kontrolli fillon nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në të, një qëndrim tashmë i konsoliduar ky në jurisprudencën e Kolegjit¹⁷. Në këtë kuptim, në ndryshim nga Komisioni, trupi gjykues vlerësoi se burimi i krijimit të pasurisë objekt kontrolli duhet të verifikohet e kontrollohet sipas asaj që subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

23.4.2 Sa i takon argumentit të dytë të përdorur nga Komisioni, se z. I. Sh. cilësohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit¹⁸, në analizë të pretendimeve të subjektit në ankim, në raport me arsyetimin dhe vlerësimin në vendim, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se shuma prej 18.500 eurosh nuk është e krijuar me burime të ligjshme. Trupi gjykues, nga një analizë kronologjike e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, në interpretim të situatës faktike në raport me legjislacionin e zbatueshëm, analizoi si vijon.

i. Marrëdhënia me vëllanë e tij, z. I. Sh., në raport me pasurinë “apartament banimi me sip. 63,82 m²”, në Durrës, fillimisht është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si një marrëdhënie/marrëveshje bashkëpronësie, edhe pse kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit e ka nënshkruar i vetëm, në cilësinë e palës porositëse, në datën 09.08.2005;

¹⁷ Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021; vendimi nr. 2/2022, datë 15.02.2022, etj.

¹⁸ Faqja 29 e vendimit të Komisionit.

ii. Marrëdhënia e përshkruar më sipër është shndërruar më pas, në vitin 2010, në një marrëdhënie shitblerjeje të pjesës takuese të pasurisë “apartament banimi me sip. 63,82 m²”, në Durrës, nga subjekti i rivlerësimit tek vëllai i tij, z. I. Sh., i cili siç deklarohet nga të dy palët pjesëmarrëse në këtë marrëdhënie, pretendohet të ketë paguar shumën prej 18.500 eurosh si çmim blerjeje, edhe pse ky ishte një çmim më i lartë se çmimi fillestar i blerjes prej tij të pjesës takuese të pasurisë (rreth 11.500 euro);

iii. Më datë 02.04.2012, subjekti i rivlerësimit, i vetëm, në cilësinë e palës blerëse, ka lidhur kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2012, me shoqërinë sipërcituar dhe apartamenti është regjistruar në emër të subjektit në ZVRPP-në Durrës, më datë 15.05.2012;

iv. Më datë 13.07.2012, subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij, z. I. Sh., kanë redaktuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., në të cilën kanë deklaruar marrëdhënien e tyre ndër vite lidhur me pasurinë “apartament banimi me sip. 63,82 m²”. Deklarimet e palëve në këtë deklaratë, se në mars të vitit 2012 z. I. Sh. ka ardhur në Shqipëri dhe pasi e ka parë apartamentin ka konstatuar se nuk plotësonte kërkesat e tij e, për këtë arsye, nuk ka pranuar të marrë në dorëzim çelësat, nuk përputhen logjikisht me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim se në muajin prill 2010, kohë kur z. I. Sh. së bashku me familjen kanë qenë në Shqipëri, subjekti i rivlerësimit i ka dorëzuar atij, blerësit *de facto* të pasurisë, edhe çelësat e apartamentit, të cilat i ka pranuar duke futur në apartament sendet personale dhe ka qëndruar sa herë ka ardhur në Shqipëri deri në vitin 2012 dhe ua ka lënë edhe vëllezërve dhe motrave të tjerë në përdorim, gjatë sezoneve verore;

v. Për trupin gjykues mbetet e pashpjegueshme, pse subjekti i rivlerësimit dhe z. I. Sh. nuk janë paraqitur përpara noterit publik, që në muajin prill të vitit 2010, moment kur është pretenduar se ka ndodhur dorëzimi faktik i pasurisë “apartament” nga pala shitëse Bari Shyti tek pala blerëse I. Sh.. Subjekti i rivlerësimit, në përmbushje të detyrimeve ligjore të deklarimit të saktë e të plotë të pasurive, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, do të duhej të ishte i interesuar të dokumentonte burimin e krijimit të shumës 18.500 euro, e përfituar nga shitja e pjesës takuese tek z. I. Sh., shumë e cila kishte shërbyer si burim krijimi për pagesën e kështit të dytë të “apartamentit me sip. 107 m²”, në Tiranë, në të njëjtin vit.

Po ashtu, i pashpjegueshëm mbetet edhe fakti se pse deklarimet përpara noterit publik nuk u bënë në muajin mars 2012, kur z. I. Sh. kuptoi se pasuria e blerë prej tij në vitin 2010 nuk ishte e përshtatshme, por këto deklarime noteriale u bënë në muajin korrik 2012, pasi pasuria ishte blerë dhe regjistruar në regjistrat publikë në emër të subjektit të rivlerësimit;

vi. Në harkun kohor 2005-2012, subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij pretendojnë të kenë hyrë në marrëdhënie juridike të vazhdueshme blerje e shitje, mes tyre, të pjesëve takuese të pasurisë “apartament banimi me sip. 63,82 m²”, në Durrës, marrëdhënie këto të pa dokumentuara, në asnjë lloj forme. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbështetet vetëm mbi versionin e ndërtuar prej tij në deklarimet periodike të interesave;

vii. Marrëdhëniet juridike mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij z. I. Sh., në vitin 2012, janë finalizuar në një marrëdhënie detyrimi, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë përsipër t'i kthejë z. I. Sh. shumën prej 30.000 eurosh, deri në datën 31.12.2015, si dhe pagesën e interesit në masën 1.5 % të shumës së sipërcituar, për çdo muaj vonesë të shlyerjes së detyrimit;

viii. Të gjitha marrëdhëniet financiare të pretenduara se janë kryer mes subjektit të rivlerësimit dhe z. I. Sh., në harkun kohor 2005-2012, janë kryer në *cash* dhe të pashoqëruara me dokumentacion financiar;

ix. Situata e mosdeklarimit të burimeve financiare të krijimit të pagesave përkatëse për pasurinë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, në deklaratat periodike të interesave në vitet 2010 e 2011, pavarësisht se nuk e ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë subjektin, në kuptim të procesit të rivlerësimit dhe të vendosjes së masës disiplinore ndaj tij, do të shërbente në drejtim të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me përdorimin e të ardhurës prej 18.500 eurosh, për kryerjen e pagesës së kështit të parë për blerjen e këtij apartamenti;

x. Referuar dokumentacionit justifikues të të ardhurave të z. I. Sh., si emigrant në shtetin belg, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstatoi se z. I. Sh. ndodhej në kushtet e pamjaftueshmërisë së të ardhurave të ligjshme për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit shumën 18.500 euro, në vitin 2010.

23.5. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues krijoi bindjen se marrëdhënia e pretenduar e subjektit të rivlerësimit me vëllain e tij është një marrëdhënie interesi, e cila pavarësisht se nuk është formalizuar në një kontratë huaje është në thelb një marrëdhënie e tillë, pasi shuma prej 18.500 eurosh dhënë nga z. I. Sh. në vitin 2010 është përdorur nga subjekti i rivlerësimit si burim financiar për pagesën e kështit të parë të pasurisë “apartament me sip. 107 m²”, në Tiranë. Në këtë vlerësim, sipas të cilit z. I. Sh. konsiderohet si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin se vetë subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë marrëdhënie në formën e detyrimit financiar në deklaratën periodike të vitit 2012, duke deklaruar në vijim shlyerjen me këste ndër vite. Trupi gjykues krijoi bindjen se marrëdhënia e pretenduar e subjektit të rivlerësimit dhe vëllai të tij në raport me pasurinë “apartament banimi me sip. 63,82 m²”, në Durrës, është një përpjekje e subjektit për të deformuar faktet që tregojnë origjinën e shumës prej 18.500 eurosh e përdorur për pagesën e kështit të dytë të pasurisë “apartament me sip. 107 m²”, në Tiranë.

24. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, mungesa e dokumentimit të veprimeve juridike të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij në raport me pasurinë “apartament banimi me sip. 63.82 m², në Durrës”, që pretendohet se kanë sjellë si pasojë përfitimin prej subjektit të rivlerësimit të shumës prej 18.500 eurosh, afektojnë me paligjshmëri këtë shumë, pasi nuk është provuar ekzistenca e marrëdhënies nga ka buruar ajo, në kuptim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk është provuar as ligjshmëria e burimi financiar të krijimit të kësaj shume nga personi tjetër i lidhur. Për rrjedhojë, kjo shumë nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për financimin e krijimit të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë dhe, si e tillë, nuk mund të përfshihet në burimet e ligjshme në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie.

25. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të *pabazuara konkluzionet e Komisionit lidhur me tërheqjen prej tij të depozitës në Tirana Bank, që ka shërbyer si burim për pagesën e kështit të dytë*

për pasurisë apartament banimi në Tiranë, si dhe konkluzionin se nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për pagimin e shumës 400.000 lekë, në favor të z. H. Sh., në vitin 2010.

25.1. Lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, Komisioni, ka arritur në konkluzionin¹⁹ se: *“Pas rishikimit të analizës financiare, balanca negative nga (-) 890.065 lekë bëhet (-) 127.103 lekë. Pavarësisht kësaj balance negative, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti ka pasur mundësi për të kontribuar me shumën 1.600.000 lekë për krijimin e depozitës në vitin 2002. [...] shuma prej 3.203.000 lekësh që subjekti ka tërhequr nga Tirana Bank, datë 21.01.2011, për ta përdorur për pagesën e një kësti për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, është më e madhe se 1/2 pjesë takuese e tij dhe, për këtë, shkak subjekti ka pasur një detyrim prej 800.000 lekësh ndaj vëllait H. Sh., ashtu sikurse deklaroi edhe në seancë dëgjimore. Veç kësaj, duke qenë se subjekti për të paguar një këst për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, ka përdorur një depozitë dyemërore të tij dhe vëllait të tij, me qëllim heqjen e çdo dyshimi se e gjithë depozita mund të ketë qenë e tij (subjektit), Komisioni vlerësoi të kryejë verifikime mbi burimin e ligjshëm të pjesës takuese të vëllait H. Sh.. Në lidhje me këtë, subjekti ka sqaruar se të ardhurat e vëllait H. Sh., vijnë nga shitja e një banese private të tij në Bulqizë, në shumën 1.050.000 lekë, në datën 10.01.2002. Pjesa tjetër, sipas tij, është siguruar nga puna e vëllait dhe e familjes së tij. Subjekti ka vënë në dispozicion disa dokumente shkresore, të cilat nuk kanë vërtetuar të ardhura të ligjshme të vëllait të tij H. Sh.. [...] referuar dinamikës së gjithë veprimeve, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin se e gjithë depozita ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Ndërsa sa i takon shumës prej 3.203.000 lekësh, të tërhequr nga depozita në Tirana Bank në datën 21.01.2011, nuk u provua tërësisht burimi i ligjshëm i saj, përderisa pjesë përbërëse e kësaj depozite, është dhe shuma 800.000 lekë, që i takon vëllait H. Sh., për të cilën si më sipër rezultoi nuk u provua burimi i ligjshëm”.*

25.2. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se llogaritjet e Komisionit janë të gabuara, jo vetëm për faktin se ka një lapsus në vlerën e shumës, pasi nuk duhej llogaritur 800.000 lekë por 722.000 lekë, vlerë që përfaqëson saktësisht pjesën takuese të vëllait të tij H. Sh., por Komisioni ka gabuar edhe në shpërndarjen e pagimit të saj prej subjektit në analizën financiare të në vitet 2010-2011, kur në fakt kjo shumë është paguar në vitet 2009 dhe 2010, për pasojë nuk ka pasur pagesë në vitin 2011. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni, në mënyrë tinëzare, i ka hyrë dhe bashkëpronësisë së të ardhurave të z. H. Sh., duke e cituar atë në mënyrë jo të shprehur si person tjetër të lidhur. Meqenëse ky fakt nuk është vënë në themel të konkluzionit për shkarkimin nga detyra, por thjesht është përmendur, ai nuk e gjen me vend të zgjatet më tej për të argumentuar faktin se në këtë rast nuk bëhet fjalë për marrëdhënie interesi apo huaje për ta konsideruar vëllanë e tij si person tjetër të lidhur.

25.3. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

¹⁹ Faqja 34 e vendimit të Komisionit.

- Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti si një nga burimet e krijimit për pasurinë apartament në Tiranë, ka deklaruar edhe: “[...] v) tërheqje depozite nga Tirana Bank në datën 21.01.2011, në shumën 3.203.000 lekë. Kjo depozitë në shumën 1.600.000 lekë është krijuar në vitin 2002 nga kursimet deri në datën 31.12.2001, shtuar me interesa dhe pagesa nga një pjesë e kursimeve. Pjesa takuese: 100%”.

- Në deklaratën e pasurisë për vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një depozitë prej 1.600.000 lekësh, çelur në Tirana Bank, me burim krijimi “kursimet” dhe në vijim në deklaratat e interesave private në vitet 2004-2011, ai ka deklaruar rregullisht shtimin e kësaj depozite për shkak të interesave bankare.

- Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit dhe nga informacioni i përcjellë në Komision nga Tirana Bank²⁰, rezultoi se:

Në datën 30.08.2002, nga z. H. Sh. është çelur llogaria bankare depozitë me afat, me derdhje *cash* në shumën 3.200.000 lekë. Nga data 05.03.2003, në këtë depozitë, ka pasur të drejtë veprimi edhe subjekti i rivlerësimit. Kjo llogari depozite është maturuar në datën 27.12.2007, në shumën 4.078.631 lekë, së bashku me interesat Në të njëjtën datë, kjo shumë është kaluar në dy depozita të reja, në shumat 1.200.000 lekë dhe 2.800.000 lekë, në emër të z. H. Sh. dhe me të drejtë veprimi edhe nga subjekti i rivlerësimit. Depozita bankare në shumën 1.200.000 lekë është tërhequr nga z. Bari Shyti, në datën 28.10.2008. Depozita tjetër bankare, në shumën 2.800.000 lekë është maturuar më 20.01.2010 dhe, po në këtë datë, nga kjo llogari është transferuar në llogarinë individuale në lekë të subjektit të rivlerësimit pranë së njëjtës bankë, shuma prej 3.008.579 lekësh. Më pas në datën 21.01.2011, kjo shumë e shtuar me interesat bankare është transferuar në llogarinë e tij në euro në të njëjtën bankë, e konvertuar në shumën 23.000 euro. Në po këtë datë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në *cash* në të njëjtën llogari shumën 2.003 euro dhe shumën totale prej 25.000 eurosh e ka transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK, për pagesën e kështit të dytë të apartamentit.

25.4. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Kjo depozitë është çelur në vitin 2002, fillimisht si llogari e vetme e vëllait H. Sh., ku në emër të tij është futur në depozitë edhe shuma prej 1.6 milion lekësh që më takonte mua, dhe në mars të vitit 2003, jemi paraqitur përsëri në bankë ku është shtuar edhe emri im si bashkëpronar në këtë llogari. [...] Lidhur me këtë transfertë, ju sqaroj se ky veprim është kryer në kuadër të llogarisë së përbashkët të çelur në vitin 2002, ku unë dhe vëllai im H. Sh. kemi depozituar në Tirana Bank shumën 3.2 milion lekë, me nga 1.6 milion secili. Në këtë gjendje depozita ka qëndruar deri në vitin 2008, kur vëllai H. Sh., për nevoja të tij ka tërhequr shumën 1.2 milionë lekë, duke lënë në depozitë diferencën prej 0.4 milionë lekë dhe interesat e maturuara mbi të gjithë shumën prej 1.6 milionë lekë deri në momentin e tërheqjes prej tij të shumës 1.2 milionë lekë. Në janar të vitit 2010, është mbyllur llogaria e përbashkët, ku pasi kemi bërë të gjitha llogaritjet, kemi rënë dakord që të bëhej veprimi bankar i mbylljes së llogarisë së përbashkët, ku shuma prej 3.008.579 lekësh do të kalonte në llogarinë time, ndërsa H. do të mbyllte llogarinë e tij”.

²⁰ Informacion i përcjellë në Komision me shkresat nr. {***} prot., datë 07.02.2019, nr. {***} prot., datë 07.06.2019 dhe nr. 11330, datë 10.07.2020.

25.5. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se llogaritjet e Komisionit janë të gabuara, pasi nuk duhej llogaritur vlera 800.000 lekë, por vlera 722.000 lekë si vlerë që përfaqëson saktësisht pjesën takuese të vëllait të tij H. Sh. në depozitën bankare, trupi gjykues vëren se në datën 27.12.2007, depozita është maturuar në shumën 4.078.631 lekë së bashku me interesat, që do të thotë se pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit përbëhej nga rreth 2.039.315 lekë dhe, po ashtu, edhe pjesa takuese e vëllait të tij, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ai dhe vëllai i tij kanë qenë bashkëmbajtës të llogarisë bankare në pjesë takuese të barabarta. Megjithëse nga të dhënat bankare rezulton se në datën 28.10.2008, z. Bari Shyti ka tërhequr shumën prej 1.200.000 lekësh nga kjo depozitë, Komisioni ka pranuar pretendimin e tij të ngritur gjatë hetimit administrativ se *në vitin 2008, vëllai H. Sh., për nevoja të tij ka tërhequr shumën 1.2 milionë lekë nga depozita e përbashkët*. Për pasojë, pjesa e mbetur në pronësi të z. H. Sh. në këtë depozitë, është 839.315 lekë, duke mbajtur si bazë për llogaritjeje maturimin e depozitës në vitin 2007, ku secilit prej bashkëmbajtësve të saj i përkiste, shuma prej 2.039.315 lekësh. Për pasojë, trupi gjykues konsideroi vlerën 839.315 lekë si pjesë takuese e mbetur e z. H. Sh., nga depozita e përbashkët me subjektin e rivlerësimit. Por nga ana tjetër, duke pranuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në fakt ai ia ka kompensuar, paraprakisht, vëllait të tij pjesën takuese në depozitë, Komisioni e ka pasqyruar atë të ndarë në shumën të barabarta prej 400.000 lekësh, në zërin e shpenzimeve, në analizën financiare përkatëse, në vitet 2010 dhe 2011. Komisioni, në vendim²¹, ka arsyetuar se *ky shpenzim është ndarë në mënyrë të barabartë midis viteve 2010 dhe 2011, sikurse është deklaruar nga subjekti në seancë dëgjimore*. Nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore publike, trupi gjykues vëren se, i pyetur nga Komisioni se çfarë ka ndodhur me diferencën prej 800.000 lekësh që i takojnë vëllait H. Sh., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ia ka dhënë këtë diferencë vëllait të tij *gjatë viteve 2009-2010*. Për pasojë, trupi gjykues çmoi se kthimi i shumës prej 800.000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit tek z. H. Sh., në ndryshim nga Komisioni, duhet të zhvendoset, në të njëjtat shuma, në analizën financiare të vitit 2009 dhe vitit 2010.

25.6. Trupi gjykues e gjeti të pabazuar në prova e në ligj pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për të ardhurat e z. H. Sh. Komisioni i ka kaluar një barrë prove në tejkalim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Verifikimi i mundësisë financiare të z. H. Sh. për të krijuar pjesën takuese të depozitës në Tirana Bank, fillimisht ishte një ndër aspektet e analizuara nga Komisioni, në kuadër të heqjes së çdo dyshimi se e gjithë depozita mund të ketë qenë e financuar tërësisht nga subjekti i rivlerësimit²² dhe duke konkluduar më pas se *referuar dinamikës së gjithë veprimeve, nuk mund të arrinte në konkluzionin se e gjithë depozita ka qenë në pronësi të subjektit*. Duke mbajtur në konsideratë faktin se shumën e përfituar nga tërheqja e depozitës bankare është përdorur për kryerjen e pagesës së këstit të dytë të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, duke përfshirë edhe pjesën e mbetur të z. H. Sh. në këtë depozitë, trupi gjykues vlerësoi se z. H.

²¹ Paragrafi 2.6.2. i vendimit të Komisionit.

²² Faqe 34 e vendimit të Komisionit.

Sh. plotësonte kushtet për t'u cilësuar si person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016²³, për pasojë vlerësimi i Komisionit është i drejtë.

25.7. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka depozituar disa dokumente, të cilat, sipas Komisionit, nuk kanë arritur të vërtetojnë të ardhura të ligjshme të z. H. Sh., për krijimin e shumës 1.600.000 lekë në momentin e krijimit të depozitës bankare, në vitin 2002. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të drejtuar nga Komisioni, lidhur me burimin e të ardhurave për depozitim të shumës 1.600.000 lekë nga z. H. Sh. në Tirana Bank, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo shumë rrjedh nga: a) shitja në vitin 2002 e një shtëpie private të ndërtuar nga z. H. Sh. në fillim të viteve 1990, në shumën 1.000.000 lekë, pa akt noterial, pasi objekti ka qenë i paregjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për të provuar të ardhurat nga veprimi juridik i mësipërm, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: i) deklaratë dore (dorëshkrim) e nënshkruar nga z. H. Sh., pa datë, në të cilën ai deklaroi se në vitin 2002 ka depozituar në Tirana Bank shumën prej 1.600.000 lekësh, e krijuar nga shitja e banesës private në Bulqizë dhe nga kursimet familjare deri në vitin 2002, të cilat i ka tërhequr në vitin 2008, kur nisi të ndërtojë një shtëpi në zonën e kënetës në Durrës; ii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.10.2020, e z. M. L., i cili deklaroi se në vitin 2002 ka blerë shtëpinë e z. H. Sh. në vlerën 1.050.000 lekë, dhënë atij dorazi në prezencë të bashkëshortes; iii) deklaratë dore e z. H. Sh., i cili deklaroi marrjen e shumës prej 1.050.000 lekësh nga z. M. L., nga shitja e shtëpisë së tij në lagjen e re në Bulqizë;

b) puna e familjes së tij si shitës ambulant në plazhin e Durrësit për periudhën 2001-2002;

c) puna e familjes në mbledhjen e bimëve mjekësore, nga e cila janë kursyer 200.000 lekë;

ç) e ardhura nga pensioni si ish-minator në masën fillestare 10.700 lekë; si dhe

d) puna private si hidraulik në Bulqizë apo në zonën e plazhit në Durrës, nga e cila ka fituar 500.000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për sa më sipër nuk mund të siguronte dokumentacion ligjor dhe financiar për pagesat e kryera, si faturë tatimore blerje, shitje apo shërbimi.

25.8. Në analizë të gjithë sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se edhe nëse do të konsiderohej e mirëqenë ekzistenca e të ardhurave të z. H. Sh., të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht mungesës së dokumentacionit ligjor që i përlligj ato, këto të ardhura do të dështonin të kalonin testin e ligjshmërisë, përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, z. H. Sh. nuk mund të krijonte me burime të ligjshme financiare, shumën totale prej 1.600.000 lekë të depozituar në Tirana Bank, në vitin 2002. Për rrjedhojë, edhe interesat në shumën prej 400.000 lekësh, të rrjedhura nga depozitimi i kësaj shume në Tirana Bank për periudhën 2002-2007, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme. Në përfundim, të gjithë aspektet e rrethanave faktike, të cilat iu nënshtruan analizës ligjore, sjellin si konkluzion konstatimin e pamjaftueshmërisë dhe të paligjshmërisë së burimeve financiare të z. H. Sh., nën dritën e nenit 32, pika 4, për sa i takon shumës 800.000 lekë [e mbetur nga depozita e z. H. Sh. pas tërheqjes së

²³ Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: "4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të pasurive".

shumës 1.200.000 lekë], e cila ka shërbyer si burim krijimi për pagesën nga subjekti i rivlerësimit të kështit të dytë të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë.

25.9. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit, për të konsideruar si burim të ligjshëm për financimin e pagesës së kështit të dytë të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, në vitin 2011, vlerën e mbetur nga tërheqja e depozitës bankare, pas zbritjes së shumës 800.000 lekë dhe, si e tillë, është përfshirë në burimet e ligjshme në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie.

26. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *në të kundërt të sa ka konkluduar Komisioni, ai ka provuar bindshëm se shuma 9.000 USD është një e ardhur e ligjshme, jo vetëm se rrjedh nga një marrëdhënie korrekte huadhënie, por edhe se huadhënësi ka pasur burime financiare të mjaftueshme dhe të ligjshme për huazimin e kësaj shume.*

26.1. Lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramentit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për huadhënien në shumën 9.000 USD, e cila është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit si një nga burimet e krijimit të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendim²⁴ se: *Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas prej 9.000 USD nga personi tjetër i lidhur, z. I. Sh., në vitin 2011, referuar fakteve dhe provave si vijojnë: i) Shoqëria “{***}” ShPK, nuk ka shpërndarë dividend gjatë vitit 2011; ii) Nuk u vërtetuan të ardhura të tjera personale të familjes së z. I. Sh. të mjaftueshme për dhënien e huas; iii) Nuk ka pasur asnjë provë konkrete që të vërtetojë marrjen e shumës prej 9.000 USD nga arka e shoqërisë prej z. I. Sh.. Fakti që shoqëria ka pasur të arkëtuara vlera të konsiderueshme monetare gjatë vitit 2011, si dhe fakti që zëri “TVSH, debitore, kreditorë të tjerë” në bilancin e vitit 2011, është gjithashtu në vlerë të konsiderueshme, nuk vërtetojnë që ky shtetas ka marrë nga arka e shoqërisë shumën 9.000 USD në formë huaje. Vetëm librat e kontabilizimit do të ishin prova që do të vërtetonin transaksionin financiar për shumën 9.000 USD, për të cilat subjekti pretendoi se nuk ka mundur t’i sigurojë për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Ky pretendim nuk qëndron, pasi, koha e ruajtjes së këtyre dokumenteve është 10 vjet pas mbylljes së vitit ushtrimor, pra periudha e ruajtjes së tyre, do të ishte fundi i vitit 2021.*

26.2. Subjekti i rivlerësimit, në argumentimin e shkakut të ngritur në ankimin e tij për kundërshtimin e arsyetimit dhe konkluzionit të mësipërm të Komisionit, ka parashtruar se huadhënësi I. Sh., vëllai i tij, duke qenë ortak i vetëm dhe njëkohësisht dhe administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, ka pasur të gjitha mundësitë për të kryer veprime në llogarinë e shoqërisë. Nga ana tjetër, provohet se në një llogari bankare të shoqërisë, para dhënies së huas, arkëtimet janë në vlera të konsiderueshme, rreth 34.000.000 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, llogaria e një shoqërie tregtare nuk mund të konsiderohet si burim i paligjshëm i një huadhënie. Marrëdhënia e huas e krijuar mes ortakut njëherësh dhe administrator me një të tretë nuk mund të ngatërrohet me marrëdhënien ndërmjet organeve të shoqërisë tregtare. Subjekti i rivlerësimit ka

²⁴ Faqja 32 e vendimi të Komisionit.

pretenduar se në bilancin e shoqërisë pasqyrohet një vlerë e konsiderueshme në zërin “detyrime të tjera” dhe këtu mund të jetë përfshirë edhe detyrimi i ortakut ndaj shoqërisë.

26.3. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, sa u takon pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

- Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, shumën prej 9.000 USD marrë hua me kontratë huaje nga vëllai i tij I. Sh., subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë. Bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.08.2011, të lidhur mes tij në cilësinë e huamarrësit dhe z. I. Sh. në cilësinë e huadhënësit, me objekt dhënien e huas në shumën 9.000 USD, për një periudhë 2-vjeçare, pa interes. Shuma e dhënë hua është dorëzuar nga huadhënësi te huamarrësi, më datë 30.06.2011.

- Marrjen e huas në shumën 9.000 USD nga vëllai i tij, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar edhe në deklaratën periodike të interesave të vitit 2011, marrë për të njëjtin qëllim, shlyerjen e këstit të tretë të apartamentit të banimit të ndodhur në Tiranë. Në të njëjtën deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka evidentuar se ka shlyer shumën prej 4.000 USD nga shuma e marrë hua, brenda të njëjtit vit.

- Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e shumës prej 5.000 USD, si pjesë e mbetur e detyrimit ndaj vëllait të tij, z. I. Sh..

- Nga verifikimi i të dhënave bankare të përcjella në Komision, rezultoi se shuma prej 5.000 USD ka kaluar me anë të një transferte të rregullt bankare në Raiffeisen Bank, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, në të njëjtën bankë, më datë 29.12.2014.

- Gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke deklaruar se shuma prej 9.000 USD dhënë hua nga vëllai në vitin 2011 e ka burimin nga të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “{***}” ShPK dhe nga kursimet familjare të tij. Shuma e dhënë hua është tërhequr nga arka e shoqërisë në fjalë dhe pas likuidimit prej subjektit, ajo është kthyer përsëri në shoqëri.

26.4. Në analizë të këtij shkaku ankimi, pas kontrollit të arsytimit në vendim lidhur me huan objekt vlerësimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas, e ka bazuar në argumentin e vetëm se *nuk ka pasur asnjë provë konkrete që të vërtetojë marrjen e shumës prej 9.000 USD nga arka e shoqërisë prej z. I. Sh.*²⁵. Komisioni, këtë qëndrim, e ka mbështetur në faktin e provuar gjatë hetimit administrativ se *vetëm librat e kontabilizimit do të ishin prova që do të vërtetonin transaksionin financiar për shumën 9.000 USD, për të cilat subjekti pretendoi se nuk ka mundur t’i sigurojë për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.*

²⁵ Referuar në paragrafin 24.1 më sipër në këtë vendim.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, gjatë hetimit administrativ²⁶, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bilancet e shoqërisë për vitin 2010 dhe vitin 2011, ndërsa për pjesën tjetër të dokumentacionit ka deklaruar se lidhur me kontabilizimin e arkës për të paraqitur mandatpagesat dhe mandatarkëtimet, për të shpjeguar veprimet e kryera me arkën e shoqërisë, ky dokumentacion nuk është ruajtur nga shoqëria, pasi ka kaluar një periudhë e gjatë rreth 10-vjeçare, por edhe për faktin që dokumentacioni dhe regjistrimet kontabël ruhen për një periudhë gati 5-6 vjeçare për efekt të organit tatimor dhe kontrollove që mund të kryhen.

Trupi gjykues vëren se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, konkretisht nenit 17, me titull “Ruajtja e dokumenteve”, i cili parashikon se: “Regjistrat kontabël dhe evidencat mbështetëse ruhen për 10 vjet rresht pas mbylljes së vitit ushtrimor kontabël, të cilit i përkasin, përveç atyre që, me ligj ose akt tjetër nënligjor, përcaktohet një afat më i gjatë ruajtjeje. I njëjti afat zbatohet edhe për dokumentet informatike (bartësit) dhe printimet e tyre”, shoqëria “{***}” ShPK kishte detyrimin e ruajtjes së dokumentacionit kontabël brenda harkut kohor nga fillimi i vitit 2012 deri në fund të vitit 2021, një detyrim ky i pa përmbushur prej saj. Ekzistenca e librit të kontabilizimit të arkës së shoqërisë do të ofronte mundësinë e verifikimit nëse shuma prej 9.000 USD është tërhequr nga arka e shoqërisë prej ortakut të vetëm/administratorit të saj, z. I. Sh., për t’ia dhënë më pas hua subjektit të rivlerësimit në vitin 2011.

26.5. Pavarësisht konfirmimit të mungesës së librit të kontabilizimit të shoqërisë “{***}” ShPK dhe mospërmbushjes së detyrimit ligjor prej saj për ruajtjen e këtij dokumentacioni, trupi gjykues çmon se ky fakt nuk mund t’i atribuohet subjektit të rivlerësimit si i vetmi fakt determinues, në favor të konkluzionit se ai nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas prej 9.000 USD nga personi tjetër i lidhur - administratori i shoqërisë - por Komisioni duhet të analizonte në harmoni rrethanat dhe faktet e tjera të provuara gjatë hetimit administrativ, si më poshtë:

i. deklarimi i huas si burim krijimi për pagesën e kështit të tretë për pasurinë apartament banimi në Tiranë nuk është një deklaram i posaçëm i kryer nga subjekti i rivlerësimit, vetëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por ka qenë një deklaram i bërë që në deklaratat periodike të interesave të viteve 2011 e 2014;

ii. subjekti i rivlerësimit ka qenë konsekuent në të gjitha deklaramet e tij gjatë hetimit administrativ të Komisionit, duke parashtruar se si burim për krijimin e shumës prej 9.000 USD dhënë hua nga vëllai i tij kanë shërbyer shuma të tërhequra nga arka e shoqërisë “{***}” ShPK, në të cilën ai ishte ortak i vetëm dhe administrator, si dhe kursime të familjes së tij;

iii. kthimi i pjesës së parë të detyrimit për huan në shumën 4.000 USD është kryer nga subjekti në *cash* kundrejt vëllait të tij, por nga Komisioni është anashkaluar, fakti tjetër i provuar gjatë hetimit administrativ se pjesa e dytë e detyrimit prej 5.000 USD, i është kthyer huadhënësit nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet transaksionit bankar, në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, në Raiffeisen Bank. Komisioni e ka evidentuar këtë fakt në vendim²⁷, por nuk e ka vlerësuar atë, madje ka arsyetuar se: “Por, nuk ka një provë që vërteton marrjen e huas nga z. I. Sh. në vlerën

²⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. 5 të drejtuar nga Komisioni.

²⁷ Paragrafi (ii), në fillim të faqes 32 të vendimit të Komisionit.

9.000 USD nga arka e shoqërisë, si dhe shlyerjen e këtij detyrimi ndaj shoqërisë”. Fakti që subjekti i rivlerësimit e ka shlyer detyrimin në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, në rrugë bankare në vitin 2014, provon të kundërtën e konstatimit të sipërcituar të Komisionit;

iv. ligji i kohës, nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nuk parashikonte ndalim për dhënien e huave ndaj të tretëve nga shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Nga verifikimi i burimeve zyrtare të hapura, konkretisht të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, për shoqërinë “{***}” ShPK, trupi gjykues vëren se edhe në statutin e kësaj shoqërie, me ortak të vetëm e administrator z. I. Sh., nuk parashikohej një kufizim apo ndalim i kësaj natyre, për dhënien e huave ndaj të tretëve;

v. në një vlerësim të përgjithshëm të situatës financiare të shoqërisë “{***}” ShPK, nga të dhënat e bilanceve të saj të konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, për vitet 2008-2010, trupi gjykues konstaton se ajo ka pasur një gjendje financiare të shëndoshë, vërtetuar nga qarkullimi vjetor dhe nga fitimi i konsiderueshëm, megjithëse i pashpërndarë, si dhe nga borxhet e dhëna nga shoqëria ndaj të tretëve. Gjithashtu, shoqëria ka paguar rregullisht të gjitha detyrimet tatimore, sipas legjisllacionit tatimor në fuqi.

26.6. Në shqyrtim të fakteve dhe rrethanave të analizuara si më sipër, trupi gjykues vlerësoi se shoqëria “{***}” ShPK ka pasur mundësinë e disponimit të likuiditetit në shumën 9.000 USD, në qershor 2011, shumë e cila i është dhënë hua subjektit të rivlerësimit nga z. I. Sh., vëllai i tij e njëkohësisht ortaku dhe administratori i shoqërisë, ndonëse ky veprim nuk evidentohet dot saktësisht, për shkak të mungesës së librit të kontabilizimit të mbajtur nga shoqëria në vitin 2011. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin se ruajtja apo jo e librit të kontabilizimit nga ana e shoqërisë “{***}” ShPK apo qoftë edhe mënyra e pasqyrimit të të dhënave financiare në të, del jashtë mundësisë së kontrollit të subjektit të rivlerësimit dhe, si e tillë, nuk mund të penalizojë atë në kuadër të procesit të rivlerësimit, në drejtim të provimit të faktit se kjo shumë është marrë nga huadhënësi nga arka e shoqërisë, për sa kohë ka rezultuar e provuar se subjekti i rivlerësimit pjesën më të madhe të detyrimit e ka shlyer me transaksion bankar në llogarinë bankare të shoqërisë, fakt ky i konstatuar edhe nga Komisioni në vendim.

26.7. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se është vërtetuar burimi i ligjshëm i të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas prej 9.000 USD dhënë subjektit të rivlerësimit nga personi tjetër i lidhur, z. I. Sh., në vitin 2011, në përputhje me parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, shuma prej 9.000 USD e marrë hua është konsideruar nga trupi gjykues si burim i ligjshëm për financimin e krijimit të pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë dhe, si e tillë, është përfshirë në burimet e ligjshme në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie.

27. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision, në mbështetje të arsyetimit dhe konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, lidhur me ligjshmërinë e burimeve financiare të deklaruara për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 107 m², në Tiranë, balanca negative reduktohet në vlerën prej (-) 5.332.094 lekësh. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

28. *Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit lidhur me konfliktin në dukje të interesit gjatë gjykimit të tri çështjeve civile, në të cilat palë ndërgjyqëse ka qenë shoqëria “{***}” ShPK.*

28.1. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, duke parashtruar se, edhe pse ky konstatim nuk është vlerësuar se ka ndikuar në vendimmarrjen e Komisionit, ai e kundërshton atë, pasi marrëdhënia e tij me shoqërinë “{***}” ShPK kishte përfunduar që në vitin 2015, duke mos pasur asnjë lidhje interesi ndërmjet tyre në kohën kur janë gjykuar çështjet e referuara nga Komisioni. Sipas parashikimeve të nenit 3, pika 4 e ligjit nr. 9367/2005, nuk ka ekzistuar asnjë nga format e shfaqjes së konfliktit të interesit ndërmjet subjektit të rivlerësimit si gjyqtar dhe shoqërisë në fjalë, që ai të ishte i detyruar të deklaronte dorëheqjen nga gjykimi i çështjeve, në kuptim të nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konstatimi i Komisionit për shkelje të etikës gjyqësore është krejtësisht i gabuar.

28.2. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi se, në analizën dhe arsyetimin mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, në vendim, në paragrafin e titulluar “Konstatime të tjera”, Komisioni ka referuar: *“6. Gjatë hetimit administrativ shtesë, Komisioni kreu verifikime në drejtim të evidentimit të ndonjë rasti konflikti të mundshëm interesi, duke kërkuar nga gjykatat, ku subjekti ka ushtruar detyrën, informacione për çështje të shqyrtuara prej tij, me palë pjesëmarrëse shtetasit me të cilët ka qenë në marrëdhënie juridiko-civile apo shtetasit me të cilët ka udhëtuar, referuar të dhënave të sistemit TIMS. Në përfundim të procesit të rivlerësimit u evidentua se në tri raste të gjykimit të çështjeve civile me palë pjesëmarrëse në proces, shoqërinë “{***}” ShPK, subjekti ishte në kushtet e konfliktit në dukje të interesit (trajtuar në rubrikën rivlerësimi i aftësive profesionale)”.*

Më tej, në paragrafin “Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë”, Komisioni ka konkluduar: *“Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit Bari Shyti: (i) ka kryer deklarime të pasakta e që vijnë në kundërshtim me ligjin, si dhe në disa raste janë konstatuar mospërputhje të deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit me DPV-të dhe akte të administruara gjatë hetimit administrativ (shkronja “a”, e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016); (ii) ka mungesë të burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak të balancave negative në total prej (-) 10.299 552 lekësh (germa “b”, e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016); (iii) subjekti është ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (shkronja “d”, e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016)”.*

Në analizën dhe arsyetimin lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, ka arsyetuar dhe konkluduar: *“Pavarësisht faktit se marrëdhënia juridiko-civile mes tij dhe shoqërisë “{***}” ShPK, në kohën e trajtimit të tri çështjeve civile kishte përfunduar, Komisioni vlerëson se për të shmangur çdo lloj dyshimi për njëanshmëri në gjykim, si dhe për të shmangur çdo situatë konflikti në dukje të interesit, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte operuar me dorëheqje nga gjykimi i çështjeve. [...] Në përfundim, bazuar në të gjitha*

*dispozitat e mësipërme ligjore, Komisioni vlerësoi se gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e “konfliktit në dukje të interesit” gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes në çështjet ku palë pjesëmarrëse në gjykim ka qenë shoqëria “{***}” ShPK, konflikt për të cilin nuk u vërtetua të ketë ndërmarrë ndonjë veprim për mënjanimin e tij. [...] Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se subjekti ka treguar aftësi profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; ka treguar aftësi organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; nuk ka treguar plotësisht etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016, pasi është gjendur në kushte të konfliktit të interesit, për shkak të gjykimit të çështjeve civile me palë pjesëmarrëse në proces, shoqërinë “{***}” ShPK; si dhe ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Bazuar në të gjitha sa më sipër është arsyetuar, sipas shkronjës “a”, të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016”.*

28.3. Në kushtet kur Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur, gjithsesi, një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues vëren se konstatimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit *nuk ka treguar plotësisht etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016, pasi është gjendur në kushte të konfliktit të interesit, për shkak të gjykimit të çështjeve civile me palë pjesëmarrëse në proces, shoqërinë “{***}” ShPK, nuk rezulton të ketë ndikuar në vlerësimin e aftësive profesionale e, për pasojë, as në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Pavarësisht këtij konstatimi, me qëllim analizimin shterues të të gjitha shkaqeve ankimore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues shqyrtoi edhe pretendimin e tij, ashtu siç është pasqyruar më sipër në këtë vendim, se konstatimi i Komisionit për shkelje të etikës gjyqësore është krejtësisht i gabuar.*

28.4. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

28.4.1 Subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që ka shqyrtuar:

(i) çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 05.09.2016, me palë paditëse: P. Ç., i paditur: {***}, si person i tretë shoqëria “{***}” ShPK, me objekt: “Detyrimi për të shpronësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për sipërfaqen e pronës 2.100 m² të marrë për ndërtimin e rrugës publike “Unaza lindore Tiranë”. Me këtë vendim, gjykata ka vendosur: *Lënie në fuqi të vendimit nr. {***} akti, datë 18.05.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke marrë masën për pezullimin e kontratës nr. {***}, datë 03.06.2013, në objektin Unaza lindore Tiranë, Loti 1, segmenti i rrugës Sauk-TEG, deri në marrjen e shpronësimit;*

(ii) çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 06.06.2018, me palë paditëse: 27 banorë të Njesisë Administrative {***} dhe shoqata “{***}”, me palë të paditur: {***}, si person i tretë: shoqëria “{***}” ShPK, shoqëria “{***}” ShPK dhe {***}, me objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. {***}, datë 10.11.2017, “Për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 08.09.2016”. Me këtë vendim, gjykata ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. {***} akti, datë 31.01.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar pezullimin e punimeve në zbatim të aktit administrativ, vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 12, datë 10.11.2017, “Për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit për objektin ndërtim i Hidrocentralit Dragobia, Komuna Margegaj, Qarku Kukës, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes”;*

(iii) çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 05.03.2019, me palë paditëse: {***} dhe shoqëria “{***}” ShPK dhe palë të paditur: {***}²⁸, {***} dhe {***}, me objekt: “Anulim/shfuqizim i urdhrin nr. {***}, datë 10.02.2017, të Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana Rurale”. Me këtë vendim, gjykata ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 29.10.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

28.4.2 Subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë qenë palë në marrëdhënien juridiko-civile që buronte nga lidhja e kontratës së sipërmarrjes datë 12.03.2010 dhe kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2015, me objekt shitblerjen e pasurisë “apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë.

28.5. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit në raport me situatën faktike si më sipër pasqyruar, në raport me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues vlerësoi se, megjithëse marrëdhënia juridiko-civile mes subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK kishte përfunduar në kohën e shqyrtimit të çështjeve civile të cituara më sipër në këtë vendim, pjesëmarrja e tij në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues krijonte kushtet për ekzistencën e konfliktit “në dukje” të interesit. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 4 përkufizon konfliktin “në dukje” të interesit, si *gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisë të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.* Në vijim, në nenin 37, i njëjti ligj, parashikon mënyrat që përdor Zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, për të mënjeluar dhe zgjidhur vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë veprime për mënjanimin e kësaj situate, brenda mundësive që parashikonte neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, në të cilin përcaktohen rastet se kur gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete.

29. Në përfundim, edhe pse qëndron përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që të mënjanohte konfliktin “në dukje” të interesit, trupi gjykues vlerësoi se kjo rrethanë nuk mund të përbëjë shkelje, referuar

²⁸ Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe as të sjellë pasojën e shkarkimit nga detyra në procesin e rivlerësimit, në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë gjykuar ndonjë çështje në kushtet e konfliktit të interesit. Sa më sipër, trupi gjykues e gjeti pretendimin e subjektit të rivlerësimit të bazuar në fakte dhe në ligj.

30. Për pasurinë “automjet tip “Mercedes-Benz C200 CDI””, viti i prodhimit 2003, Komisioni, në vendim²⁹, ka arritur në konkluzionin se nga analiza financiare e kryer deri në datën 11.08.2015 kur është blerë automjeti, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të krijuar këtë pasuri me burime të ligjshme financiare, në vlerën (-) 120.725 lekë. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në ankim, nuk ka parashtruar pretendime, në kundërshtim të konkluzionit të sipërcituar të Komisionit. Në këto kushte, bazuar në nenet 302, 459 dhe 465, pika 4 e Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vlerësoi se e shqyrton çështjen duke marrë në analizë vetëm shkaqet që ka parashtruar subjekti i rivlerësimit në ankim, për pasojë konkluzionet e Komisionit në vendim, lidhur me pasurinë “automjet tip “Mercedes-Benz C200 CDI””, u konsideruan se kanë rënë në dekadencë. Për pasojë, trupi gjykues konfirmoi konkluzioni e arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- *Për analizën financiare 2003-2016*

31. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat ai ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit për periudhën 2003-2016, e cila ka rezultuar me balancë negative, në shumën totale prej (-) 10.299.552 lekësh. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se një analizë financiare e bazuar në pretendimet e tij do të rezultonte në një balancë pozitive, e cila provon bindshëm se ai ka pasur të ardhura të ligjshme, mjaftueshme për të përballuar shpenzimet dhe për të krijuar pasuritë. Trupi gjykues shqyrtoi e analizoi fillimisht pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat shtrihen për të gjithë vitet e, më tej, pretendimet të cilat lidhen me zëra të caktuar financiarë, për vitet përkatëse.

32. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit se *nga ana e Komisionit, pa ndonjë argument bindës, për periudhën 2000-2012, nuk është marrë në konsideratë fakti që një pjesë të produkteve ushqimore ai i ka siguruar nga toka bujqësore me sip. 5,7 dynym në pronësi të tij.*

32.1. Komisioni, në vendim³⁰, në paragrafin e titulluar “Analiza financiare”, ka arsyetuar se: *Komisioni ka vlerësuar që shpenzimet e jetesës t’i konsiderojë si vijon: (i) nga nëntori i vitit 1993 deri në fund të vitit 1999, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur në masën 30% të të ardhurave familjare; (ii) në periudhën 2000-2016, janë marrë sipas standardit të ILDKPKI-së referuar gjithnjë INSTAT-it, pasi këto shpenzime janë të mesatarizuara në shkallë vendi dhe nuk mund të*

²⁹ Paragrafët 4-4.2 të vendimit të Komisionit.

³⁰ Faqja 48 e vendimit të Komisionit.

reduktohen; (iii) shuma prej 330.000 lekësh e deklaruar si e ardhur nga toka bujqësore në DPV-të e viteve 2012-2014, është zbritur nga shpenzimet e jetesës për këto vite; (iv) sa i takon pretendimeve për shpenzimet jetike për vitin 2016, ishin përlllogaritur në mënyrë të saktë nga Komisioni.

32.2. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtimin e përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka argumentuar, në ankim, se shpenzimet për jetesë do të duhet të reduktoheshin me vlerën e përfitimeve nga konsumi i produkteve bujqësore dhe blegtorale të siguruara nga toka bujqësore në pronësi të tij, në masën 40.000 lekë në vit, për vitet 2000-2003 dhe në masën 60.000 lekë në vit, për vitet 2004-2011. Në deklaratimet e para të pasurisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë një vlerë të saktë të të mirave materiale të përfituara nga bujqësia dhe blegtoria, pasi ka vlerësuar se ndikimi i tyre është përfshirë te shpenzimet e jetesës, për rrjedhojë ka arritur të kursejë nga pagat, vlerat e deklaruara në vite. Të ardhurën nga produktet bujqësore e blegtorale ka filluar ta deklarojë si të ardhur më vete, vetëm pas kalimit në kontroll të plotë në ILDKPKI, në vitin 2012. Pretendimin e tij, subjekti i rivlerësimit nuk e konsideron deklarativ, ashtu si pa të drejtë e ka konsideruar Komisionit, por të provuar, pasi: (i) ka në pronësi mbi 5,7 dynym tokë bujqësore dhe ka jetuar për gjithë periudhën 2000-2013, në fshatin/qytetin ku ndodhet toka; (ii) produktet e prodhuara nga bujqësia e blegtoria janë përdorur për konsum vetjak dhe, për rrjedhojë, nuk ka vend për të diskutuar tatimin mbi këtë të ardhur; (iii) Komisioni duhet të mbante të njëjtin qëndrim siç ka mbajtur në pakësimet e shpenzimeve për periudhat 1993-1999 dhe 2012-2014, për të cilat ka llogaritur mbulimin e shpenzimeve nga produktet bujqësore deri në raportin 70% të vlerës së nevojave për ushqim. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, gjithashtu, se shpenzimet e jetesës për familjen e tij duhet të përlllogariten edhe duke afektuar diferencimin e standardit të shpenzimeve në rajonin e Dibrës, e cila është 21% më e ulët se mesatarja e kostos së jetesës e mesatarizuar.

32.3. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, por edhe në vendim, i ka bërë të ditur subjektit të rivlerësimit metodologjinë e përdorur në kryerjen e analizës financiare, si dhe standardet e njohura mbi të cilat bazohet kjo metodologji, lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të jetesës. Komisioni ka shpjeguar se shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur bazuar në ato mujore për konsum, sipas përbërjes familjare të pasqyruar në anketën e buxhetit të familjes nga INSTAT-i. Referuar sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se sa i takon metodologjisë së përdorur, Komisioni ka zbatuar standardin tashmë të konsoliduar në kryerjen e analizës financiare për periudhën e vlerësimit 2003-2016, nëpërmjet zbatimit të vlerave të përcaktuara, sipas shkresës së ILDKPKI-së, me nr. {***} prot., datë 04.03.2019, standard i përdorur për të gjithë subjektet e rivlerësimit. Shpenzimet e jetesës për periudhën 1993-1999 janë llogaritur nga Komisioni në masën 30% të të ardhurave, referuar standardit të llogaritjes së këtyre shpenzimeve orientuar nga jurisprudenca e Kolegjit³¹ dhe jo e ndikuar nga përdorimi i produkteve bujqësore e blegtorale, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Për vitet 2012-2014, shpenzimet e jetesës sipas standardit të sipërcituar janë pakësuar nga Komisioni me vlerën e të ardhurave nga produktet bujqësore dhe blegtorale, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike

³¹ Vendimi i Kolegjit nr. 15/2021 (JR).

vjetore të këtyre viteve. Komisioni, në vendim³², ka referuar se *në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni çmoi të mos anashkalojë deklaratimet e subjektit në deklaratimet periodike vjetore për të ardhurat nga toka bujqësore gjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014. Pavarësisht se shuma prej 330.000 lekësh nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme për shkak të mungesës së çdo të dhëne që do të legjitimonte këtë të ardhur, Komisioni vlerësoi që për këto vite shpenzimet e jetesës të reduktohen me shumën e deklaruara nga subjekti në këto deklaratime periodike vjetore.* Trupi gjykues, në verifikim të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, vlerësoi se shumën e deklaruara prej tij në deklaratimet periodike vjetore 2012-2014, si të ardhura nga produktet bujqësore e blegtorale, nuk mbështeten në asnjë të dhënë që rrjedh nga dokumentacioni provues, në kohën e përfitimit të tyre, për pasojë nuk e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit, që ka reduktuar për këto vite, shpenzimet e jetesës, me shumën e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në këto deklaratime periodike vjetore, përkatësisht në vlerat 130.000 lekë, 130.000 lekë dhe 70.000 lekë. Komisioni, edhe pse ka arsyetuar drejt, në përfundim, në mënyrë kontradiktore, i ka përllogaritur shpenzimet e jetesës bazuar në deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit, të paprovuara me dokumentacion justifikues. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se ky vlerësim i Komisionit për vitet 2012-2014 nuk mund të shtrihet për periudhën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, pasi nuk e gjeti të mbështetur në dokumentacion provues, pretendimin e tij, për uljen e shpenzimeve të jetesës në vlerën e përfitimeve nga konsumi i produkteve bujqësore dhe blegtorale të pretenduara si të siguruar nga toka bujqësore në pronësi të tij, për vitet 2000-2003 dhe për vitet 2004-2011. Edhe pse arsyetimi i Komisionit, lidhur me përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën 2012-2014, u vlerësua si një përllogaritje jo e drejtë dhe objektive, trupi gjykues vlerësoi që në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, të mos ndryshojë vlerat e përllogaritura nga Komisioni, në zërin “Shpenzime jetese”, në analizën financiare për vitet 2012-2014.

32.4. Përpos sa më sipër, trupi gjykues mbajti në vëmendje edhe qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit në jurisprudencën e tij se në kushtet kur shpenzimet mujore të përdorura si referencë përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, si emërues i përbashkët që përfshin gjithë fashat e pagave dhe përfitimeve në Republikën e Shqipërisë, shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste³³. Shpenzimet e jetesës, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, kanë për qëllim të standardizojnë dhe unifikojnë këto shpenzime për të gjithë shtetasit shqiptarë. Këto shpenzime janë mesatare dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, çka do të thotë se ato nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet reale të çdo individi dhe familjeje. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson një jetesë normale të një njësie familjare dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për diferencimin e standardit të shpenzimeve në rajonin e Dibrës me 21%, vjen në kundërshtim me standardin e përdorur nga Kolegji, për të gjithë subjektet e rivlerësimit.

³² Faqja 45 e vendimit të Komisionit.

³³ Vendimi i Kolegjit nr. 29/2020 (JR).

33. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar mënyrën e përlllogaritjes nga Komisioni të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, duke pretenduar se *Komisioni nuk i ka llogaritur drejt ato pasi i ka korrigjuar pjesërisht dhe, në vendimin përfundimtar, jo vetëm nuk ka njohur disa udhëtime me kosto qëndrimi të mbuluar nga të tretët, por edhe në ato dy raste që ka pranuar se kostoja e qëndrimit është mbuluar nga të tretët, nuk është i qartë në atë se çfarë ka njohur si kosto ditore.*

33.1. Komisioni, në vendim³⁴, në paragrafin e titulluar “Analiza financiare”, ka arsyetuar: *7. Rishikimin e shpenzimeve të udhëtimit sipas sistemit TIMS për vitet 2008, 2009 dhe 2011–2016, duke pretenduar se shpenzimet janë përballuar nga pala pritëse e duke vënë në dispozicion disa dokumente shkresore. Pasi u kryen verifikimet për sa pretendon subjekti, bazuar në aktet shkresore që ka vënë në dispozicion, shpenzimet e udhëtimeve janë rishikuar nga Komisioni bazuar në metodologjinë tashmë të konsoliduar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe konkretisht: (i) për vitin 2009 është marrë i mirëqenë fakti se subjekti dhe familja e tij kanë qenë për vizitë te vëllai I. Sh. në Belgjikë; (ii) për vitin 2013 udhëtimet në Maqedoni, Kosovë dhe Mal të Zi janë konsideruar si udhëtime 1-ditore dhe jo 14 dhe 22-ditore sikurse ishin përlllogaritur nga Komisioni për dy nga udhëtimet. Pretendimi i subjektit qëndron, pasi përputhet me deklaratimet në pyetësorin standard, si dhe nga vulat kufitare në pasaportë; (iii) për vitin 2015, kur subjekti ka udhëtuar në Bruksel-Belgjikë, është konsideruar se ka qëndruar te vëllai I. Sh.; (iv) për vitin 2016, për vajzën e subjektit janë konsideruar vetëm shpenzimet e biletave dhe jo të akomodimit pas shtatorit 2016, pasi ajo studion në Itali; (v) nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e subjektit sa i takon shpenzimeve të udhëtimit për vitet 2008, 2011 dhe 2012 dhe pretendimet mbi koston e kartonit jeshil, pasi këto pretendime mbeten në nivel deklarativ. Bazuar në sa më sipër, në total, shpenzimet e udhëtimit janë reduktuar në vlerën 649.186 lekë, duke ndikuar përkatësisht në rezultatin financiar të viteve 2009, 2013, 2015 dhe 2016, ndryshime të cilat subjektit i janë bërë me dije me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ shtesë.*

33.2. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim se Komisioni duhet të kishte përlllogaritur si kosto qëndrimi 5 euro në ditë për çdo person në udhëtimet jashtë vendit: në periudhën 28.12.2009-07.01.2010, udhëtim familjarisht në Belgjikë; 06.03.2011-19.03.2011, udhëtim i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në Belgjikë; 02.11.2011-06.11.2011, udhëtim i subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten drejt Italisë; 21.08.2014-02.09.2014, udhëtim familjarisht në Belgjikë; 24.08.2015-25.08.2015, udhëtim familjarisht në Korfuz; 04.02.2016-08.02.2016, udhëtim i subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten drejt Italisë.

33.3. Nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioni në raport me pretendimet e mësipërme, trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion shkresor nga personat pritës në vendet ku ka udhëtuar, me qëllim vërtetimin e përballimit prej tyre të kostove të qëndrimit të subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes së tij, në kundërshtim me parashikimin e nenit

³⁴ Faqja 48 e vendimit të Komisionit.

49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016³⁵. Në mbështetje të këtij konstatimi dhe në referim të metodologjisë së përdorur në jurisprudencën e Kolegjit³⁶, trupi gjykues vlerësoi se zëri “Shpenzime udhëtimit jashtë vendit” është përlllogaritur drejt nga Komisioni, në analizën financiare të viteve 2009, 2010, 2011, 2014 dhe 2016.

Sa i përket përlllogaritjes së kësaj tipologjie shpenzimesh, trupi gjykues konstatoi se për udhëtimin familjar drejt Korfuzit, në vitin 2015, Komisioni nuk ka përlllogaritur saktë koston e udhëtimit, referuar burimeve të hapura të informacionit, lidhur me udhëtimet me traget në linjën Sarandë-Korfuz-Sarandë. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se zëri “Shpenzime udhëtimit jashtë vendit”, në analizën financiare të vitit 2015, duhet të pasqyrohet nga vlera 192.524 lekë e përlllogaritur nga Komisioni, në vlerën e reduktuar prej 147.788 lekë.

34. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *konkluzioni i Komisionit se ka qenë në pamundësi financiare për të shlyer shumën prej 4.000 USD, në vitin 2011, ka ardhur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të deklaratës periodike të interesave të vitit 2011, duke shfrytëzuar edhe ndonjë gabim në mënyrën e deklarimit apo hapësirën e deklaratës ku janë pasqyruar kursimet*, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, ka arsyetuar në vendim³⁷: [...] lidhur me konstatimin mbi pamundësinë financiare për të shlyer shumën prej 4.000 USD në vitin 2011, subjekti ka prapësuar se kjo pagesë është bërë nga kursimet e vitit 2011, të cilat kanë qenë në shumën 800.000 lekë shtuar edhe ato të mbartura nga viti 2010 në shumën 200.000 lekë. Pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë, pasi nga verifikimi i DPV-ve për vitet 2010 dhe 2011 duket se më 31.12.2011 subjekti ka pasur gjendje cash në shumën 1.000.000 lekë dhe, për këtë arsye, kjo shumë nuk mund të ketë shërbyer për të kthyer huan ndaj vëllait I. Sh. në shumën 4.000 USD gjatë vitit 2011, sikurse është deklaruar nga subjekti. Për rrjedhojë, kthimi i huas në shumën 4.000 USD, është pasqyruar si shpenzim në analizën financiare të vitit 2011, nga e cila duket se subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme për të kryer këtë pagesë, pasi rezulton me balancë negative.

34.1. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtimin e arsyetimit dhe konkluzionit të mësipërm të Komisionit, ka parashtruar se sa i përket balancës së vitit 2011, edhe në shpjegimet e dhëna në përfundim të hetimit administrativ, por edhe nga përlllogaritjet e ekspertit të caktuar prej tij, ka pranuar se rezulton një balancë e vogël negative, por kjo mund të ketë ardhur dhe si pasojë e interpretimit të gabuar nga Komisioni i deklaratës periodike, sa i përket kursimeve të vitit të deklarimit.

34.2. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën e interesave të vitit 2011, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar huan e marrë në datën 01.07.2011, në shumën 9.000 USD, pa interes, me afat kthimi dyvjeçar, me qëllim shlyerjen e kështit të tretë të pagesës për blerjen e pasurisë

³⁵ Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit të bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

³⁶ Vendimi i Kolegjit nr. 11/2019 (JR).

³⁷ Faqja 32 e vendimit të Komisionit.

“apartament banimi me sip. 107 m²”, në Tiranë, si dhe shlyerjen e një pjese të saj në shumën 4.000 USD.

Në interpretim të deklaratave periodike të interesave lidhur me kursimet e deklaruara në *cash*³⁸, trupi gjykues vëren se në periudhën 2003-2006 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në total, 1.100.000 lekë gjendje kursimesh në *cash*. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision, trupi gjykues vëren se rezultoi bilanc negativ për periudhën 2003-2006, bilanc pozitiv për vitin 2007 dhe bilanc negativ për vitet 2009 dhe 2010, çka dëshmoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të krijonte kursimet e deklaruara në *cash* në shumën 300.000 lekë, për vitin 2007, ndërsa nuk kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme financiare kursimet në *cash* në shumën prej 1.100.000 lekësh për periudhën 2003-2006, si dhe në shumat prej 300.000 lekësh dhe 500.000 lekësh, përkatësisht në vitet 2009 dhe 2010.

34.3. Në vijim të konstatimeve të mësipërme, trupi gjykues mbajti në konsideratë se: (i) nga analiza më sipër në këtë vendim, u konkludua se pagesa për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sip. 57,64 m²”, në Durrës, është kryer tërësisht në vitin 2005, për pasojë deklarimi i subjektit të rivlerësimit për pakësimin e kursimeve në *cash*, në shumën 1.400.000 lekë, në vitin 2007, nuk i përgjigjet së vërtetës; (ii) në deklaratën periodike të interesave të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si gjendje kursimesh në *cash* shumën 1.000.000 lekë, e përbërë nga 800.000 lekë nga kursimet e vitit 2011 dhe 200.000 nga kursimet e vitit 2010, çka nënkupton se këto shuma disponoheshin prej tij në datën 31.12.2011, për pasojë nuk mund të kenë shërbyer si burim financiar për shlyerjen e huas në shumën 4.000 USD ose 420.320 lekë³⁹; (iii) në deklaratën periodike të interesave të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin financiar të pagesës në shumën 4.000.USD për shlyerjen e një pjese të huas dhe as datën e saktë të këtij veprimi.

34.4. Në përfundim, bazuar në sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se në fillim të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit mund të dispononte vetëm shumën prej 300.000 lekësh si kursime në *cash* të krijuara me burime të ligjshme financiare. Për rrjedhojë, shuma 4.000 USD ose 420.320 lekë nuk rezultonte e shlyer plotësisht nga kursimet në *cash*, të cilat në analizën financiare të vitit 2011 do të pakësohen në vlerën 300.000 lekë.

³⁸ Në deklaratat periodike të interesave, lidhur me kursimet në *cash*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

Në vitin 2003: nuk ka deklaruar kursime në *cash*.

Në vitin 2004: gjendje në *cash* 250.000 lekë.

Në vitin 2005: kursime nga pagat e mia dhe të bashkëshortes për vitin 2005 në shumën 450.000 lekë.

Në vitin 2006: kursime nga pagat e mia dhe të bashkëshortes për vitin 2005 në shumën 400.000 lekë.

Në vitin 2007: Me kursimet e deklaruara më parë dhe ato të vitit të deklarimit prej 300.000 lekësh, është blerë sipërfaqe banimi 32m² në Plazh, Durrës, e paregjistruar. Vlera: 1.400.000 lekë.

Në vitin 2008: Nuk ka deklaruar likuiditete në *cash*.

Në vitin 2009: Kursimet nga pagat e mia dhe të bashkëshortes. Vlera: 300.000 lekë.

Në vitin 2010: Kursime nga paga ime dhe nga paga e bashkëshortes. Vlera: 500.000 lekë.

Në vitin 2011: Kursimet e vitit 2011. Vlera: 800.000 lekë. Kursimet e vitit 2010. Vlera: 200.000 lekë.

³⁹ Llogaritur sipas kursit mesatar të këmbimit valutor të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2011, të monedhës 1 USD=138.3 lekë.

35. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se *deklarimi i pasaktë i shtëpisë në Bulqizë qëndron vetëm në faktin se prej tij nuk është deklaruar investimi prej 200.000-250.000 lekësh i kryer gjatë vitit 2004, për pasojë qëndrimi i Komisionit nuk është i drejtë.*

35.1. Lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të të ardhurave në shumën 650.000 lekë, të përfituara nga shitja e pasurisë “apartament banimi me sip. 74 m²”, në Bulqizë, Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendim⁴⁰: *Sa i takon mundësisë financiare për blerjen e pasurisë, subjekti ka pretenduar dhe pranuar që investimi në total për këtë pasuri ka qenë në shumën 500.000 lekë dhe jo 200.000 lekë, pretendim i cili mbetet në nivel deklarativ. Për rrjedhojë, referuar kontratës së paraqitur në ILDKPKI dhe deklarimit në deklaratën vetting, në analizën financiare përfundimtare, Komisioni ka konsideruar si shpenzim për blerjen e kësaj pasurie shumën 650.000 lekë. Për këtë arsye, balanca negative e rezultuar nga analiza financiare për vitin 2003 nuk ndryshon (-) 378.529 lekë). Megjithatë, edhe në rast se vlera e pasurisë do të konsiderohej 500.000 lekë, sipas deklarimeve të subjektit, ai përsëri nuk do të kishte pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijuar këtë pasuri, pasi viti 2003 do të rezultonte me balancë negative prej (-)228.929 lekësh.*

35.2. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar, në ankim, se lidhur me këtë çështje ai i qëndron shpjegimeve që ka dhënë gjatë hetimit administrativ në Komision, duke theksuar faktin se diferenca e vlerës mes asaj që ai ka pranuar dhe asaj që ka konkluduar Komisioni, ka të bëjë me gjendjen faktike, ku deklarimi i vitit 2003 është i saktë dhe i bazuar në prova me fuqi të plotë provuese. Sipas subjektit të rivlerësimit, pasaktësia qëndron në faktin se prej tij nuk është deklaruar investimi prej 200.000-250.000 lekësh i kryer gjatë vitit 2004, në këtë pasuri. Për të arritur në një përfundim më të saktë, Komisioni duhet të hetonte mbi çmimin mesatar të shitjeve të apartamenteve në {***}, Bulqizë, në vitin 2003.

35.3. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, sa u takon pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se:

- Në deklaratën e rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *“Shitje apartamenti 2+1, në Bulqizë. Vlera e blerjes në dhjetor të vitit 2003, 650.000 lekë. Vlera e shitjes në tetor të vitit 2014, 3.650.000 lekë. Vërtetuar me kontratat përkatëse blerje dhe shitje”.*

- Bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur kontratë shitblerje banese nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.2003, sipas së cilës pala shitëse i ka shitur palës blerëse Bari dhe E. Sh., banesën 2+1, në vlerën 650.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar. Në kontratë është parashikuar, gjithashtu, se shitësit kanë rënë dakord të kryejnë derdhjen e tatimit në masën 0.5% të kësaj vlere me qëllim që Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëjë regjistrimin banesës në emër të palës blerëse. Në kontratë, çmimi është i shënuar me shkrim dore.

- Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shtëpi banimi me sip. 70 m², 2+1, me vlerë 0.25 milionë lekë. {***}, Bulqizë. Blerë me të ardhurat e familjes”.*

⁴⁰ Faqe 44 e vendimit të Komisionit.

- Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Bulqizë⁴¹, z. Bari dhe znj. E. Sh., me anë të kontratës së shitblerjes për pasurinë e paluajtshme “apartament”, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.10.2014, kanë shitur apartamentin me sip. 74 m², në Bulqizë, në shumën 3.650.000 lekë. Ky institucion ka përcjellë edhe kontratën e blerjes së kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.2003, sipas së cilës vlera e shitblerjes së banesës është 200.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar.

- Noteri publik N. C. ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratën e shitblerjes së banesës, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.2003, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë blerë pasurinë apartament me sip. 74 m², në vlerën 200.000 lekë.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, lidhur me kërkesën e Komisionit për të shpjeguar ndryshimet e çmimit në dokumentet e administruara sa i takon shitblerjes së pasurisë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] çmimi real i paguar është ai i kontratës së paraqitur për regjistrim. Ky çmim, sipas informacionit që kam marrë, është dukshëm më i ulët se çmimi i tregut për kohën, ku çmimi mesatar i një apartamenti të rregulluar, sipas standardit të kohës, varionte nga 450.000 deri në 550.000 lekë. Fakti që për apartamentin në fjalë është rënë dakord me çmimin 200.000 lekë ka të bëjë me faktin se apartamenti ka qenë i amortizuar [...]. Kështu, pasi është marrë në atë gjendje janë investuar rreth 250.000 lekë [...]. Vlera prej 650.000 lekësh është shënuar si çmim reference pas investimit të kryer, bazuar kjo në një dokument që unë kam ruajtur, dokument ky i nënshkruar edhe nga shitësit F. S. dhe L. S., ku çmimi është shënuar me një korrigjim 650.000 lekë me shkrim dore (dyshoj se është shkrimi im). Me sa më kujtohet, me këtë akt kam dashur t’i paraprij ndonjë suate që ishte bërë edhe fenomen në atë kohë, ku për shkak të rritjes së shpejtë të çmimit të banesave në Bulqizë, shitësit gjenin pretekste për të anuluar veprimet e shitjeve. Duke qenë se isha në dijeni të faktit që znj. F. S. kishte dy fëmijë, të cilët nuk kishin nënshkruar në kontratë, kam mbajtur në mënyrë të njëanshme një dokument ku është shënuar vlera 650.0000 lekë, duke llogaritur këtu investimin e kryer, por edhe reflektimin e çmimit të tregut për një apartament të rikonstruktuar, me qëllim që nëse kishte ndonjë pretendim nga fëmijët ata të ballafaqoheshin me çmimin e ri dhe jo atë të blerjes. Nuk mund të them me siguri se sa ka qenë vlera e investuar, por në asnjë rrethanë nuk mund të ketë qenë 450.000 lekë aq sa unë e kam shënuar vlerën e këtij apartamenti në dokumentin personal për pasojë edhe në deklaratën vetting”.

- Në shpjegimet plotësuese të paraqitura përpara zhvillimit të seancës dëgjimore në Komision, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar: “Në analizën financiare, të vitit 2003, ju keni shënuar si pasuri vlerën 650.000 lekë, e cila i korrespondon apartamentit të blerë në fund të vitit 2003 me vendndodhje {***}, Bulqizë, duke iu referuar për këtë deklaratës vetting. [...] ky ka qenë thjesht dhe vetëm një gabim i rëndë i bërë nga unë gjatë plotësimit të deklaratës vetting, në një moment tensioni dhe mungese përqendrimit [...]. E thënë ndryshe, nuk ka asnjë fakt që të çon në përfundimin që vlera e asaj pasurie ka qenë 650.000 lekë [...]. Ndaj, duke pranuar gabimin, kërkoj bonsensin tuaj që t’iu referoheni deklarimeve dhe analizës që ju kam paraqitur në lidhje me këtë

⁴¹ Informacion i përcjellë me shkresë nr. {***} prot., datë 08.02.2019.

pasuri, ku vlera e blerjes ka qenë 200.000 lekë, vlerë së cilës i është shtuar vlera e investimit në vitin 2004 në shumën 250.000 lekë”.

35.4. Duke analizuar faktet e renditura si më lart, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në tërësinë e tyre, gjenden kontradiktore dhe, si të tilla, të pabesueshme, pasi ai ka ndryshuar disa herë qëndrimin për sa i takon vlerës së blerjes së pasurisë “apartament banimi me sip. 74 m²”, në Bulqizë dhe vlerës së investimit të pretenduar për rikonstruksionin e saj. Konkretisht: në deklaratën e vitit 2003 vlera e blerjes së pasurisë është deklaruar 250.000 lekë; në deklaratën e rivlerësimit është deklaruar vlera prej 650.000 lekësh si çmim i blerjes së pasurisë, në të cilin përfshihej dhe shuma prej 450.000 lekësh si shpenzime rikonstruksioni; në shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni kundërshtohet vlera e sipërcituar dhe deklarohet se në apartament, gjatë vitit 2004, është investuar shuma 150.000 lekë për rikonstruksionin e tij; më tej, në shpjegimet para seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma e investimit të kryer për rikonstruksion, gjatë vitit 2004, ka qenë 250.000 lekë. Përpos këtyre qëndrimeve kontradiktore, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se në çmimin e shënuar me shkrim dore në kontratën e ruajtur prej tij e të paraqitur në ILDKPKI është përfshirë dhe vlera e rikonstruksionit, vlerësohen jobindëse, për shkak se qëndrimi i tij, se investimi për rikonstruksion është kryer në vitin 2004, nuk përputhet me faktin se në kontratën e ruajtur prej tij e nënshkruar edhe nga pala shitëse çmimi prej 650.000 lekësh është vendosur në vitin 2003, në momentin e shitblerjes, kur subjekti sapo e kishte blerë pasurinë dhe, logjikisht, nuk mund të ishte në dijeni të shpenzimeve të sakta të nevojshme për rikonstruksionin e saj. Jobindës vlerësohet edhe pretendimi i tij se me shënimin e një çmimi më të lartë në kontratë, *ka dashur t'i paraprijë ndonjë situatë, ku për shkak të rritjes së shpejtë të çmimit të banesave në Bulqizë, shitësit gjenin pretekste për të anuluar veprimet e shitjeve, duke qenë se ishte dhe në dijeni të faktit që znj. F. S. kishte dy fëmijë të cilët nuk kishin nënshkruar në kontratë, me qëllim që nëse kishte ndonjë pretendim nga fëmijët ata të ballafaqoheshin me çmimin e ri dhe jo atë të blerjes.* Ky pretendim nuk gjen mbështetje në faktin e rezultuar gjatë hetimit administrativ, se pasuria “apartament banimi me sip. 74 m²”, në Bulqizë, është regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, në datën 22.12.2003, vetëm 12 ditë pas lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë. Por, edhe në rast se do të ndodhte ndonjë nga situatat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si më sipërcituar, veprimet e tij në kuadër të një strategjie preventive mbeten jobindëse, pasi duket e pamundur që pala shitëse të pranonte një dokument, në të cilin çmimi i shitblerjes të ishte i ndryshëm nga ai i pasqyruar në kontratën e nënshkruar në prani të noterit publik dhe të paraqitur për regjistrim në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në vijim të arsyetimit, duket e pamundur që pala shitëse e pasurisë të ketë nënshkruar, me dijeni të plotë, një kontratë shitblerjeje në të cilën çmimi i supozuar si i fituar prej saj të ishte rreth 3 herë më i lartë nga ai i përfituar realisht nga shitja e pasurisë, përveçse me dakordësinë e të dyja palëve është nënshkruar edhe një kontratë e dytë shitblerjeje, në të cilën të evidentohet çmimi i vërtetë i shitblerjes së pasurisë, i ndryshëm nga çmimi i paraqitur për organet publike, me qëllim që pala shitëse të shmangte pagimin e tatimit mbi kalimin e pronësisë. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë qëndrimi i Komisionit se vlera 650.000 lekë e deklaruar në deklaratën e rivlerësimit si vlerë e shitblerjes së pasurisë ka qenë vlera reale e shitblerjes së saj.

35.5. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se për të arritur në një përfundim më të saktë, Komisioni duhet të hetonte mbi çmimin mesatar të shitjeve të apartamenteve në {***}, Bulqizë, në vitin 2003, trupi gjykues çmoi se Komisioni kishte mjaftueshëm të dhëna nga dokumentacioni i disponuar si rezultat i hetimit administrativ, analizimi dhe vlerësimi i të cilave e kanë drejtuar në arritjen e një konkluzioni të drejtë. Hetimi i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit do të shërbente në drejtim të përfundimit të konkluzionit të arritur nga Komisioni, pasi në bazë të përcaktimeve në tabelën nr. 2, të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 08.05.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe koeficientit K”, vlera mesatare e shitjes së apartamenteve në tregun e lirë të banesave, për qytetin e Bulqizës, për vitin 2003, ka qenë 16.762 lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi. Referuar kësaj vlere, në raport me sipërfaqen prej 74 m² të pasurisë “apartament”, rezulton se vlera e shitblerjes së saj do të duhej të ishte rreth 1.240.388 lekë, një vlerë pothuajse sa gjyshtëfishi i çmimit të caktuar në kontratën e shitblerjes së pasurisë së regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe sa dyfishi i vlerës së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, e konkluduar nga Komisioni si vlera e vërtetë e blerjes së pasurisë, një qëndrim i vlerësuar i drejtë nga trupi gjykues. Për pasojë, vlera prej 650.000 lekësh do të konsiderohet në analizën financiare të vitit 2003, si shumë e shpenzuar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sip. 74 m²”, në Bulqizë.

36. Në përmbledhje të arsytimit të mësipërm, në analizë të situatës faktike dhe ligjore, trupi gjykues konstatoi se në analizën financiare 2003-2016, balanca negative e përlloritur nga Komisioni, për pasuritë dhe shpenzimet e kryera për vitet 2004, 2005, 2006, 2008, 2009, 2010, 2011, 2014, 2015 dhe 2016, duke pranuar disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit për zëra të caktuar, reduktohet nga (-) 10.299.552 lekë në (-) 8.063.063 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
37. Megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuara nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara ato u vlerësuan si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
38. Bazuar në nenin 179/b, pikat 2 e 5, në nenin F, pikat 1 e 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 302, 459 dhe 465, pika 4 e Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se e shqyrton çështjen, duke marrë në analizë vetëm shkaqet që ka parashtruar subjekti i rivlerësimit në ankim, për pasojë konkluzionet e Komisionit në vendim, të cilat nuk janë kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, u konsideruan se kanë rënë në dekadencë.
39. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Bari Shyti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 361, datë 25.03.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 361, datë 25.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Bari Shyti.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 29.05.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi